


Me arsim kundër diskriminimit



- udhëzues mbi punën për parandalimin dhe tejkalimin
e diskriminimit për profesionistët që punojnë
në fushën e arsimit dhe edukimit -



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education





Me arsim kundër diskriminimit

- udhëzues mbi punën për parandalimin dhe tejkalimin
e diskriminimit për profesionistët që punojnë në
fushën e arsimit dhe edukimit -

Podgoricë, 2018

ME ARSIM KUNDËR DISKRIMINIMIT

- udhëzues mbi punën për parandalimin dhe tejkalimin e diskriminimit për profesionistët që punojnë në fushën e arsimit dhe edukimit -

Botues:

Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ)



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Redaktore:

Daliborka Ulareviq

Autorë:

Petar Gjukanoviq

Tamara Milash

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Admir Gjoni

Qarkullim:

50

Shtyp:

Studio Mouse

Publikimi është pjesë e projektit 360° Rrethi i plotë për të drejtat e njeriut!, të cilin e realizon Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ) në partnerit me OJQ Kompania Alternative Teatrale (ATAK) nga Podgorica, Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut nga Zagrebi dhe Festivalin Ndërkombëtarë të Filmit Dokumentar (BELDOC) nga Beogradi, e në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucionin e Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian.



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e QAQ-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Hyrje	6
Ç'është diskriminimi dhe si ta njohësh atë?	7
Vetitë personale – bazat për diskriminim	11
Format e diskriminimit	13
Format e veçanta të diskriminimit	15
Gjuha e urrejtjes	20
Format e rënda të diskriminimit	22
Kur bërja e dallimit nuk është diskriminim – masat e veçanta ose të aksionit afirmativ	23
Kush janë diskriminuesit dhe viktimat e tyre?	26
Diskriminimi në arsim	27
Format e ndryshme të diskriminimit në arsim	29
Sistemi i përkrahjes së jashtme në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit në arsim	40
Dokumentet kombëtar dhe ndërkombëtar që konsistojnë në ndalimin e diskriminimit	42



Hyrje

Udhëzuesi mbi punën për parandalimin dhe tejkalimin e diskriminimit për profesionistët të cilët punojnë në fushën e arsimit dhe edukimit u krijua në kuadër të projektit *360° Rrethi i plotë për të drejtat e njeriut!*, të cilin me përkrahje të Bashkimit Evropian e realizon Qendra për Arsimim Qytetarë (QAQ) në partnerit me OJQ Kompania Alternative Teatrale (ATAK) nga Podgorica, Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut nga Zagrebi dhe Festivalin Ndërkombëtarë të Filmit Dokumentar (BELDOC) nga Beogradi, e në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe institucionin e Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi.

Një nga *objektivat specifike* të projektit është promovimi i konceptit të arsimit pa diskriminim në sistemin formal arsimor – edukues dhe zhvillimi i kulturës antidiskriminuese dhe të drejtave të njeriut ndër të rinjtë. Prandaj ky udhëzues është i dedikuar për profesionistët të cilët punojnë me të rinjtë në arsim (arsimtarët, shërbimet profesionale, drejtuesit e shkollave, këshillat e prindërve, trupat profesionale dhe aktivët) me qëllim që tu ndihmohet në njohjen, parandalimin dhe procedimin e rasteve të diskriminimit, shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut dhe dhunës brenda institucioneve shkollore dhe në institucionet jashtë sistemit arsimor.

Në udhëzues janë shpjeguar hollësisht nocionet e diskriminimit dhe të manifestimeve të ndryshme të tij, rolet dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve të procesit edukues – arsimor, ndërsa është dhënë edhe pasqyrimi i kornizës legjislativë dhe institucionale e cila i mbron qytetarët nga diskriminimi dhe shkelja e të drejtave të njeriut, së bashku me procedurën e procedimit të rasteve, si dhe pasqyrimi i dokumenteve dhe standardeve më të rëndësishme ndërkombëtare në këtë fushë.

Objektivi përfundimtar i udhëzuesit është që si mjet ndihmës në punë me të rinjtë, madje edhe në arsim, të kontribuojë në zhvillimin, nxitjen dhe kultivimin e kulturës antidiskriminuese përmes arsimit.



Ç'është diskriminimi dhe si ta njohësh atë?

E drejta për jodiskriminim është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe prandaj ndalimi i diskriminimit është i përcaktuar me një sërë dokumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe është i integruar në sistemet bashkëkohore nacionale demokratike dhe juridike si një nga parimet kushtetuese.

Diskriminimi është një nga format më të rënda të kërcënimit të të drejtave të njeriut dhe është i dëmshëm për individët dhe për shoqërinë në tërësi. Të drejtat e njeriut i kemi të gjithë. Na takojnë prej lindjes, gjegjësisht për faktin që jemi njerëz, janë universale dhe i takojnë të gjithëve pa dallim, janë të patjetërsueshme sepse nuk janë rezultat i meritës apo shpërblimit, nuk mund të shiten dhe as të tjetërsohen dhe janë të pandashme, që do të thotë se të gjithë të drejtat e njeriut kanë rëndësi të njëjtë. Për shembull, të drejta të njeriut janë e drejta për jetë, liria e lëvizjes, liria e shprehjes dhe të ngjashme.

Shteti nuk i përcakton të drejtat e njeriut, por ka obligim të krijojë dhe zbatojë ligjet dhe masat të tjera të cilët i mbrojnë dhe i përmirësojnë. Respektimi i të drejtave të njeriut bazohet në besimin se çdo njeri është njëjtë i vlefshëm dhe se askujt nuk guxon t'i tjetërsohet e drejta që të lëviz i lirë, të mendojë dhe të shprehë mendimin e vet, që në baza të barabarta të marrë pjesë në jetën e shoqërisë, të përparojë sipas aftësive të veta, të jetë i liruar nga torturimi dhe sjelljes jonjerëzore dhe nga diskriminimi. **Të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit krijojnë mundësinë që secili nga ne të zhvillohet dhe të arrijë maksimumin e potencialeve personale.**

Çdo njeri ka një sërë të drejtash dhe obligimesh tjera të cilat shteti i përcakton me ligje e të cilët rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, kryerjen e roleve profesionale, etj. Mirëpo, të gjithë ligjet me të cilët rregullohet jeta e njerëzve në një shoqëri duhet të bazohen në respektimin e plotë dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si parime dhe vlera kryesore të shoqërisë bashkëkohore demokratike.

Diskriminimi ngjanë kur sjellja ndaj njerëzve të caktuar është e ndryshme në krahasim ndaj të tjerëve, në situatë të njëjtë apo të krahasueshme, vetëm për arsye se i takojnë apo mendohet se i takojnë grupit të caktuar, gjegjësisht për shkak të ndonjë vetisë së tyre personale.



Diskriminimi është i rrezikshëm sepse nënkupton dallimin e pajustificuar i cilët prodhon qasje dhe gëzim të pabarabartë të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në thelbin e të vepruarit diskriminues janë stereotipat dhe paragjykimet, gjegjësisht qëndrimet e përgjithshme të cilët i krijojmë duke u bazuar në informatat e paplota, shpesh edhe të pasakta, e të cilët ndiqen nga ndjenjat e fuqishme, siç janë frika, ndonjëherë edhe urrejtja. Për shembull, qëndrimet që të gjithë Romët janë përtac, të pistë dhe të prier për plaçkitje, ose që femrat janë "gjinia më e dobët", që e kanë vendin në kuzhinë dhe në kryerjen e punëve shtëpiake, ose se të gjithë homoseksualët janë persona "të sëmurë" dhe "pervers". Të gjithë kemi paragjykime dhe stereotipa, por është e rëndësishme që t'i vetëdijesohemi në mënyrë që të hapemi ndaj njerëzve të tjerë, të kemi më shumë mirëkuptim dhe t'i pranojmë si të barabartë me ne.

Paragjykimet lehtë shndërrohen në diskriminim dhe ndikojnë që, nën veprimin e tyre, të fillojmë të sillemi ndaj të tjerëve si ndaj të ndryshmëve nga ne duke u larguar prej tyre, duke i izoluar, duke iu kufizuar atyre gëzimin e të drejtave dhe lirive, duke iu ndaluar që në mënyrë të barabartë të ndajnë me ne hapësirën, të arsimohen, të punësohen dhe të punojnë, madje edhe duke vepruar dhunshëm (aktet individuale të dhunës, e deri tek aktivitetet e organizuara, të planifikuara dhe sistematike siç ishte tmerri i holokaustit). Kështu diskriminimi përcaktohet edhe si dukuri kur individit ose grupit i njerëzve shpallen si më pak të rëndësishëm në krahasim me individët dhe grupet tjera, prandaj, në bazë të kësaj, në mënyrë "legjitime" i shkurtohen ose kufizohen të drejtat dhe liritë. Nazizmi si ideologji legjitimoi diskriminimin i cili evoluoi në tjetërsimin e miliona njerëzve, kryesisht Hebrenj, Romë dhe të tjerë të cilët u shpallen rrezik për "pastërtinë" dhe "përsosmërinë" e racës ariane.

Diskriminimi parandalon zhvillimin personal të personit, zhvillimin e talenteve të tija/saja dhe përmbushjen e të gjithë potencialeve të cilat personi i caktuar i mbart në vete, ndërsa është e rëndësishme të theksohet se diskriminimi anulon mundësitë, si për zhvillimin individual, ashtu edhe për zhvillimin e gjerë të komunitetit shoqëror.

Shpesh, në mënyrë të gabuar, diskriminimi barazohet me çdo shkelje të të drejtave. **Diskriminimi gjithmonë është njëkohësisht edhe shkelje e të drejtës (një ose më shumë), edhe pse e njëjta nuk vlen për situatën e anasjellët.** Shpesh si shembull i demarkacionit përmendet situata *kur kompania nuk i paguan punëtorëve kompensimin për punën jashtë orarit*. Me këtë veprim i shkelen të drejtat e punës të gjithëve. Nëse kompensimi do t'i paguhej një grupi të punëtorëve, por jo edhe grupit tjetër i cili përbëhet nga Romët, atëherë mund të flitet për ekzistencën e diskriminimit.

Për të kuptuar më thjesht nocionin shpesh përdoret formulimi i cili **diskriminimin e definon si të vepruarit e ndryshëm ndaj të barabartëve, gjegjësisht njëjtë ndaj të pabarabartëve.**

Në përpunimin e mëtejshëm, mund të thuhet se diskriminimi paraqitet atëherë kur ndaj një njeriu ose grupi për shkak të ndonjë vetie të tyre personale vepron në mënyrë më të pafavorshme në krahasim me personin ose grupin tjetër në situatë të



njëjtë apo të ngjashme. Për shembull: *administrata nuk lejon regjistrimin në shkollë të mesme të vajzës e cila është HIV pozitive*. Bëhet fjalë për diskriminimin tek gëzimi i të drejtës për arsim në bazë të gjendjes shëndetësore. Nuk ekziston asnjë arsye mjekësore ose arsye tjetër e justifikuar që personit i cili jeton me HIV ti ndalohej regjistrimi në shkollë, gjegjësisht që të trajtohet ndryshe nga moshatarët të cilët nuk e kanë këtë sëmundje kronike, sepse ai nuk paraqet asnjë rrezik për rrethinën meqë infeksioni nuk transmetohet përmes kontakteve sociale.

Diskriminimi paraqitet edhe kur ndaj një personi ose grupi veprohet në mënyrë të njëjtë, edhe pse ndonjë veti e tyre personale i vendos në pozicion i cili kërkon dhe arsyeton trajtimin e ndryshëm. Këtë e ilustron shembulli i mirënjohur: *kur nga nxënësit të cilët kanë nevoja të veçanta arsimore do të kërkohej që të punojnë në mënyrën e cila nuk i përshtatet karakteristikave, interesimeve dhe mundësive të tyre, e që, përveç kësaj, shkolla nuk i përshtatet nevojave të tyre*. Të vepruarit e tillë i cili është i njëjtë për të gjithë i vendos në pozitë më të vështirë dhe prodhon pasoja të pafavorshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në krahasim me fëmijët e tjerë.

Pra, **diskriminimi mund të jetë të vepruarit dhe trajtimi i pabarabartë i personit ose grupit për shkak të ndonjë vetie personale ose të vepruarit i cili është i barabartë, por që për një person ose grup prodhon pasoja të mëdha të pabarazisë, sepse janë injoruar vetitë personale të cilat kërkojnë dhe justifikojnë të vepruarit ndryshe**. Në të dy rastet diskriminimi ngjau për arsye se një person ose grup u vendos në pozitë të pabarabartë ndaj personit ose grupit tjetër vetëm në bazë të ndonjë vetie personale.

Në mënyrë diskriminuese mund të veprohet duke **bërë** ose duke **mos bërë**. Për shembull: *nëse administrata e shkollës përcaktoi rregullin që nxënësit/et e kombësisë Rome nuk guxojnë të shfrytëzojnë mensën e shkollës, kemi të bëjmë me të vepruarit diskriminues duke bërë*. Diskriminimi *duke mos bërë paraqitet nëse në hyrje të shkollës ose brenda objektit shkollor nuk është siguruar mobiliteti (nuk janë vendosur hyrjet lehtësuese dhe ashensorët, nuk janë shkruar me alfabetin e Brajlit emërtimet e klasave dhe hapësirave të tjera shkollore, etj.), në mënyrë që të sigurohet qasja, qëndrimi dhe lëvizja e barabartë fëmijëve me invaliditet në institucionin shkollor*.

Ndalimi i diskriminimit është kategori kushtetuese. Me kushtetutë është i ndaluar çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi çdo lloj baze. Përrjashtim nga ndalimi paraqesin dispozitat dhe përcaktimi i masave të veçanta të cilat kanë për qëllim krijimin e kushteve për realizimin e barazisë së plotë nacionale, gjinore dhe të përgjithshme dhe mbrojtjen e personave të cilët mbi çdo lloj baze janë në pozitë ndjeshëm të pabarabartë dhe zbatohen gjersa mos të arrihen qëllimet për të cilët janë përcaktuar (masat e aksionit afirmativ, gjegjësisht masat e diskriminimit pozitiv).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) definojnë diskriminimin në këtë mënyrë: „...diskriminimi nënkupton trajtimin e ndryshëm, pa arsye objektive dhe të



justifikuar, të personave në situata relativisht të ngjashme".¹ Në bazë të praktikës së GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi jep përcaktimin e hollësishëm të këtij nocioni: „Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e përcakton diskriminimin si trajtim të ndryshëm të rasteve të njëjta apo të ngjashme, kur për këtë gjë nuk ka shkak të arsyeshëm dhe objektiv, gjegjësisht, nëse nuk synohet qëllimi legjitim, ose nuk ekziston proporcioni në mes qëllimit dhe mënyrës në të cilën ky qëllim legjitim dëshirohet të arrihet”.²

Zhvillimi i shtetit dhe shoqërisë në të gjithë sferat e jetës dhe ndaj çdo qytetari, bazohet në respektimin dhe avancimin e vazhdueshëm të të drejtave të njeriut, të barazisë dhe barabarësisë si parime kyçe antidiskriminuese.

Ligji për Parandalimin e Diskriminimit definon diskriminimin si „si krijim juridik apo faktik i diferencës ose të vepruarit e pabarabartë, gjegjësisht mungesën e të vepruarit ndaj një personi, përkatësisht grupit të personave në krahasim me personat e tjerë, si dhe përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë ndonjë personi në krahasim me personat e tjerë, e cila bazohet në racën, ngjyrën e lëkurës, përkatësinë nacionale, prejardhjen shoqërore ose etnike, lidhshmërinë me ndonjë popull pakicë ose komunitet nacional pakicë, gjuhën, religjion ose bindjen, mendimin politik ose tjetër, gjininë, ndryshimin e gjinisë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe/ose karakteristikat interseksuale, gjendjen shëndetësore, invaliditetin, moshën, gjendjen pronësore, gjendjen martesore ose familjare, përkatësinë në grup ose supozimin e përkatësisë në grup, partin politike ose organizatat tjera, si dhe vetitë e tjera personale”.³

Ligji për Parandalimin e Diskriminimit përcakton paraqitjen e diskriminimit si trajtim të pabarabartë, diferencimin në bazë të karakteristikave personale me të cilin shkelen parimet e barazisë për shkak të të vepruarit të pabarabartë, të privuarit nga e drejta, të vendosurit pa arsye në pozitë më të keqe, privilegjimit ose vendosjes në pozitë më të mirë pa arsye reale, etj.

„Diskriminim është edhe nxitja, të ndihmuarit, dhënia e instruksioneve, si dhe qëllimi i paralajmëruar që një person ose grup personash të diskriminohet mbi ndonjërin bazë nga paragrafi 2 i këtij neni (veti personale)”.⁴

Pra, **çdo formë e diskriminimit, mbi çdo bazë është e ndaluar me ligj.** Ligji zbatohet njëjtë për shtetasit dhe jo shtetasit e Malit të Zi, ndërsa fakti që dikush pranoi të diskriminohet nuk e liron personin i cili e bënë diskriminimin nga përgjegjësia.

U vendos korniza institucionale në mënyrë që qytetarët e Malit të Zi të mund të paraqiten dhe të lajmërojnë rastet e diskriminimit dhe të fitojnë mbrojtje adekuate.

1 ESLjP, Willis v. the United Kingdom (App. No. 36042/97) 11 June 2002, paragrafi 48

2 Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi, 14 qershor 2012, U-I br. 33/11

3 Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 046/10, 040/11, 018/14, 042/17

4 Njëjtë



Vetitë personale – bazat për diskriminim

Dallimet në mes njerëzve janë të përhershme, janë të pashmangshme dhe janë të mirëpritura. Njerëzit janë të ndryshëm mbi disa baza dhe mbajnë pozita të ndryshme në shoqëri. Mirëpo, ky pozicionim duhet të bazohet në matës objektiv dhe të gjithë, pavarësisht në statuset e ndryshme në shoqëri, duhet të kenë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara. Dallimi shndërrohet në diskriminim atëherë kur vetëm për shkak të disa vetive personale njerëzve i privohet e drejta për trajtim dhe mundësi të barabartë në shoqëri, gjegjësisht e kanë të vështirësuar realizimin e të drejtave të njeriut dhe lëvizshmërinë shoqërore sepse i përkasin religjionit, gjinisë apo orientimit seksual të caktuar, gjegjësisht kanë karakteristika të tjera personale të mbrojtura me ligj.

Shoqëria është demokratike atëherë kur në vend të ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, orientimit seksual ose gjinisë njerëzit zënë pozita të ndryshme në bazë të aftësive, dijes dhe punës së vet.

Me ndalimin e diskriminimit mbrohet parimi i barazisë, e kur qytetarët janë të pabarabartë në realizimin e të drejtave dhe lirive në pozitën e vet për shkak të ndonjë vetie personale, është e qartë që ekziston diskriminimi.

Diskriminimi bazohet **në dallimin dhe trajtimin e pabarabartë në bazë të ndonjë karakteristike personale**. Nëse arsimtari jep notën më të mirë ndonjë nxënësi për arsye se është simpatik, edhe pse për dallim nga nxënësit tjerë nuk ka treguar më shumë dije, atëherë mungesa e objektivitetit dhe shkelja e rregullave dhe procedurave profesionale të vlerësimit lidhen me profesionin dhe rolin e arsimtarit, por jo me diskriminimin. *Për diskriminim mund të flitet në rastin nëse arsimtari ia jep nxënësit Rom notën më të ulët në krahasim me nxënësin i cili nuk i takon popullatës Rome, vetëm për arsye se nuk e simpatizon për shkak të përkatësisë së tij etnike ose ngjyrës së lëkurës, edhe pse të dy në mënyrë të njëjtë dhe mirë e kanë bërë testin e dijes.*

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit përcakton **listën e vetive dhe karakteristikave** të cilët nuk guxojnë të jenë bazë për dallim kur bëhet fjalë për qasje të njëjtë të të drejtave, të pozitës në shoqëri dhe mundësisë për përparim në fusha të ndryshme të jetës. Kjo listë përfshinë gjininë, moshën, racën dhe përkatësinë etnike, religjionin, bindjen politike ose tjetër, invaliditetin, orientimin seksual, e përveç kësaj edhe gjendjen pronësore, arsimin, pozitën shoqërore, gjendjen shëndetësore, statusin e punës, gjuhën, etj. Literatura juridike i përkufizon vetitë personale edhe **si baza të mbrojtura**.



Vetitë personale, si bazë e diskriminimit, mund të jenë me të lindur ose të fituara. Me të lindur janë, për shembull, ngjyra e lëkurës dhe gjinia. Vetitë e fituara janë ato të cilat i adoptojmë ose i fitojmë gjatë jetës, por të cilat mund t'i ndryshojmë, si bindjet politike ose statusi pronësor, gjegjësisht statusi martesor, etj. **Pavarësisht a janë me të lindur apo të fituara, vetitë personale nuk mund të jenë bazë për trajtim ose veprim të pabarabartë.** Fakti që jemi gjini të ndryshme nuk mund të krijojë asnjë bazë të arsyeshme për diferencim në lartësinë e pagës për të njëjtën punë të cilën e kryejmë. Si bazë për diskriminim paraqitet jo vetëm vetia personale reale, por edhe ajo **e supozuar**. Për shembull: *dikush i cili nuk është pjesëtar i popullatës LGBT, por punon në organizatën e cila avokon të drejtat e këtij grupi, mund të jetë viktimë e diskriminimit për arsye se orientimi i tij seksual supozohet në mënyrë të gabuar.* Ligji për Ndalimin e Diskriminimit rreptësisht ndalon diskriminimin pavarësisht se a është bërë trajtimi i ndryshëm në bazë të vetisë personale reale apo të supozuar.

Ngjashëm, personi mund të jetë i diskriminuar në bazë të vetisë personale të ndonjë anëtarit të familjes së tij, të mikut të afërt ose të ndonjë personi me të cilin mbanë kontakt të afërt. Për shembull, *kur tërë familjet janë viktimë të diskriminimit për arsye se fëmija i tyre është përfaqësues/e e LGBT popullatës ose është HIV pozitiv.*

Edhe pse në ligje, deklarata, konventa dhe dokumente të tjera shpesh ceket lista e vetive personale, ajo asnjëherë nuk është e mbyllur dhe përfundimtare, sepse lihet mundësia që, duke u bazuar në eksperiencë, në te të radhiten edhe disa veti të tjera personale për të cilët vërtetohet se janë bazë e shpeshtë mbi të cilën bëhet diskriminimi.

Format e diskriminimit

Diskriminimi, siç thuhet shpesh, është një term me shumë fytyra.

Në ndarjen më bazike diskriminimi mund të jetë i **drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë**, gjegjësisht **direkt ose indirekt**.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit e përkufizon diskriminimin e drejtpërdrejtë si „fenomenin që me aktin, veprën ose duke mos vepruar personi ose grupi i personave, në situatë të njëjtë apo të ngjashme, vihen ose janë vënë, gjegjësisht mund të vihen në pozitë të pabarabartë në krahasim me personin ose grupin e personave të tjerë mbi ndonjërën bazë nga paragrafi 2 i këtij neni (ndonjërën nga vetitë personale)“.⁵

Diskriminimi i drejtpërdrejtë (direkt) ekziston atëherë kur faktorët të cilët nuk janë të lidhur me meritat, aftësitë ose potencialin e personit ose gupit të njerëzve përdoren si arsye bazë për të vepruarit e pafavorshëm ndaj këtyre personave ose grupeve. Diskriminimi është direkt atëherë kur të vepruarit është shkaktuar nga ndonjëra bazë diskriminuese me të cilën personi vihet, është vënë, ose mund të vihet në pozitë më të pafavorshme nga personi tjetër në situatë të njëjtë apo të ngjashme/krahasuese.

Diskriminimi direkt në arsim ndodh kur *arsimtari i arsimit teknik deklaron se në garën e kësaj lëndë do të shkojnë vetëm nxënësit meshkuj, sepse të marrurit me teknikë nuk është për vajza, duke vendosur kështu në pozitë të pafavorshme dhe duke i diskriminuar në bazë të përkatësisë gjinore të gjitha vajzat të cilat i intereson teknika dhe dëshirojnë të aftësohen në këtë fushë. Ose, kur kujdestari i klasës refuzon të bisedojë me prindin e nxënësit i cili është Rom, ose nuk i fton në mbledhjet e prindërve siç i fton prindit e nxënësve të tjerë. Po ashtu, nëse vëren mbajtjen e paradës së krenarisë kujdestari i klasës i paralajmëron nxënësit që t'i shmangen „paradimit“, ju flet barsoleta banale për personat LGBT dhe i paralajmëron se çdo kush i cili në çfarë do forme përkrah paradën do të ketë punë me te. Më tej, diskriminim është edhe kur nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk i është mundësuar të shkojë në shëtitjen shkollore për arsye se profesori mendon se nuk është i aftë të marrë pjesë në aktivitete të bashku me fëmijët e tjerë, duke injoruar faktin se ky lloj i aktivitetit mund të bëhet i qashtë edhe për fëmijën me aftësi të veçanta arsimore. Diskriminimin direkt e karakterizon fakti se ai që e bënë nuk ka nevojë të fshehë qëllimin që dikë ta diskriminojë.*

Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë (indirekt) ekziston „nëse rregulli në dukje neutral i



dispozitës ose i një akti të përgjithshëm, kriteri ose praktika i vënë ose mund t'i vejë personin ose grupin e personave në pozitë të pabarabartë në krahasim me personat ose grupet e personave të tjerë, mbi ndonjë bazë nga paragrafi 2 i këtij neni (vetitë personale), përveç se nëse ky rregull, kriter ose praktikë është në mënyrë të arsyeshme i justifikuar nga qëllimi i ligjshëm, duke përdorur mjetet të cilat janë të përshtatshëm dhe të nevojshëm për arritjen e qëllimit, gjegjësisht në relacion të pranueshëm me qëllimin që dëshirohet të arrihet”.⁶

Diskriminimi indirekt është më e vështirë të dallohet prandaj është edhe më i rrezikshëm. Shpesh, në literaturë, përmendet shembulli *kur në shpalljen për vendin e punës së profesorit të edukimit fizik përveç të tjerash kërkohet që kandidati duhet të jetë më i gjatë se 180 centimetër*. Kjo shpallje, në dukje e zakonshme, me kërkesa neutrale vendos në pozitë të pafavorshme kandidatet, sepse kjo gjatësi trupore tek femrat është më e rrallë se tek meshkujt. Ose, *nëse profesori përcakton rregullin se nxënësit i bëjnë detyrat e shtëpisë dhe ia dërgojnë me mail (në adresën e postës elektronike) nga shtëpia*, atëherë në pozitë të pafavorshme janë të gjithë ato të cilët në shtëpi nuk kanë qasje në internet. Pra, diskriminimi indirekt ngjanë atëherë kur ndonjë rregull ose praktikë është e përcaktuar në atë mënyrë që marginalizon të caktuarën. Për dallim nga diskriminimi direkt, në rastin e diskriminimit indirekt, ai që diskriminon nuk dëshiron që sjellja e tij diskriminuese të jetë e dukshme, prandaj me qasjen e tij të barabartë në dukje bënë qëllimin e tij diskriminues. E ndonjëherë ai që diskriminon nuk është aspak i vetëdijshëm se po vepron në atë mënyrë.

Format e veçanta të diskriminimit

Me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit u definuan edhe format e veçanta të ndaluara të diskriminimit ndër të cilët janë edhe ngacmimi, ngacmimi seksual, segregacioni dhe gjuha e urrejtjes.

Ngacmimi është sjellja që shkakton shkeljen e dinjitetit të personit të diskriminuar mbi ndonjë bazë dhe krijimin e ambientit të frikshëm, armiqësor, nënvlerësues dhe ofendues. Në Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit thuhet: „çdo sjellje e padëshiruar, duke përfshirë edhe ngacmimin përmes kontrollit audio dhe video, pajisjeve mobile, rrjeteve sociale dhe internetit, e cila ka për qëllim dhe pasoja e së cilës është shkelja e dinjitetit personal, shkaktimi i frikës, të ndjerit i poshtëruar ose i ofenduar apo krijimi i ambientit armiqësor, nënçmues dhe ofendues vlerësohet si diskriminim“.⁷

Shembull i këtij lloji të diskriminimit në arsim do të ishte kur grupi i nxënësve tallet, e thërret shokun e klasës me emra nënçmues për shkak të orientimit të tij seksual, real apo të supozuar, dhe me zë të lartë komentojnë si të gjithë "pederastët" duhet të vriten. Ose, kur klasa e përqesh arritjet e shokut të vet vetëm për shkak të vetisë ose përkatësisë së tij personale, gjegjësisht kur nxënësin Rom shokët nga klasa e përqeshin, sepse nuk din gjithmonë të përdor rasat gjatë të folurit, e flet gjuhën e shumicës me theks, ose lexon më ngadalë, ndërsa arsimtari nuk reagon të parandalojë këtë nënçmim.

Përqeshja e pamjes fizike, prejardhjes sociale, gjinisë, orientimit seksual ose të ndonjë vetie tjetër personale, si nga ana e nxënësve ashtu edhe nga ana e profesorëve, po ashtu është shembull i ngacmimit, pavarësisht a vjen nga nxënësit apo arsimtarët. Për shembull: profesori "argëton" klasën duke përqeshur pamjen fizike të shoqes së tyre, nxënëses së tij, duke e quajtur të frytë dhe injorante, ose kur arsimtari i flet nxënësve barsoleta që kanë temë ndonjërin nga grupet pakicë. Shembull i ngjashëm do të ishte ai kur profesori imiton dhe i përqeshet të ecurit, të folurit apo pamjes së nxënësit me pengesa në zhvillim ose invaliditet.

Përveç atij verbal ekziston edhe ngacmimi ose përcmimi me gjeste, siç është qitja e gjuhës, ose kur, për shembull nxënësit mbyllin hundën sikur diçka kundërmon kur kalojnë afër shokëve të vet të klasës të cilët janë Rom. Në literaturë përmenden edhe shembujt e frikësimit të qenit guidë i cili i asiston nxënësin i cili shikon dobët, ose të shkelmimit të shkopot të bardh, pështymja, etj.

Po ashtu, **ngacmimi seksual** paraqet lloj të diskriminimit. Ka të bëjë me gjuhën seksiste me të cilën viktimës i komentohe pamja fizika me aluzione të qarta seksuale, të



ftuarit për marrëdhënie seksuale, etj. Seksizmi bëhet edhe me gjeste, për shembull, me shikime, me dërgimin e puthjeve ose duke bërë grimasë ose gjeste të cilët kanë konotacion seksual, duke pickuar ose goditur prapanicën, me ledhatime ose përkëdhelje të cilat viktimat nuk i ka miratuar, etj.

Ngacmimin seksual Ligji e definon si „sjellje të padëshiruar, verbale, jo verbale ose fizike të natyrës seksuale, me të cilën dëshirohet të shkelet dinjiteti i ndonjë personi ose grupi të personave, gjegjësisht me të cilën arrihet ky rezultat, e në veçanti kur sjellja e tij shkakton frikë dhe krijon ambient armiqësor, nënçmues, frikësues, degradues dhe poshtëruues“.⁸

Për shembull, drejtori i shkollës në takim me kolegët profesorët, njofton kolegen që mund të shkojë në seminar/aftësim profesional vetëm nëse para syve të të gjithëve e puth në faqe, ose kur arsimtari „tallet“ me nxënësen e cila është adoleshente duke përdorur aluzionet seksuale, nxit shokët nga klasa të komentojnë pamjen e saj, etj. Shembull ngacmimit verbal seksual janë shakatë me konotacion seksual, komplimentimi i tepërt, thirrjet e shpeshta telefonike dhe SMS mesazhet dhe mailet e papërshtatshme, si dhe ngacmimet e këtij lloji përmes rrjeteve sociale.

Viktimizimi është formë e diskriminimit kur viktimat e cila është e diskriminuar, ose dikush që dëshiron t'i ndihmojë viktimës, ose refuzon të veprojë në mënyrë diskriminuese, vendoset në pozitë të pabarabartë për shkak të veprimit të vet. Bëhet fjalë për **presion dhe revanshizëm të palejuar**, vazhdim të shkeljes së trajtimit të barabartë të personit i cili denoncoi diskriminimin, morri pjesë në procesin e mbrojtjes nga diskriminimi, ose shprehu qartazi qëllimin që ta bëjë këtë, e në mënyrë që në të të bëhet presion që të heq dorë nga qëllimi i tij.

Pra, e viktimizuar mund të jetë viktimat e diskriminimit e cila vendosi të kërkojë ndihmë juridike ose përkrahje për zgjidhjen e çështjes së saj. Për shembull: nxënësi i thotë profesorit i cili e nënçmon dhe diskriminon që, nëse vazhdon të sillet në këtë formë, do ta denoncojë rastin tek drejtori i institucionit. Profesori pas kësaj fillon ta kërcënojë që nëse e bënë këtë gjë nuk do të marrë notë kaluese, sepse ai do të gjejë mënyrën që gjatë testimit t'i parashtrijë kërkesat të cilat nxënësi nuk do të mund t'i plotësojë dhe bënë edhe kërcënime të tjera. Ose, personi i cili ishte i pranishëm në situatën kur ndodhi ngacmimi ose mobingu dhe është i gatshëm të dëshmojë për këtë situatë, tani vet përjeton ngacmime dhe mobing (drejtorja nuk e dërgon në trajnime shtesë, bënë lloje të tjera të presionit, e nënçmon, nuk i përgjigjen kërkesave të tija, etj.). Shembull i viktimizimit mund të jetë edhe kur nxënësi i cili ndihmoi moshatarin gjersa grupi i shokëve të klasës e kanë ofenduar dhe kërcënuar se si do ta rrahin sepse është „gej i fëlliqur“, fillon pas këtij reagimi të marrë kërcënime dhe ofendime nga po i njëjti grup.

Pikërisht frika nga viktimizimi është faktori më i shpeshtë i cili shkakton raste të pa



lajmëruara të diskriminimit, mos inicimin e proceseve për mbrojtjen nga diskriminimi ose mungesën e reagimit gjatë dëshmimit të rastit.

Në Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit Viktimizimi përmendet në nenin 4 i cili titullohet *Personat të cilët denoncojnë diskriminimit*, e në të cilin thuhet se *"askush nuk mund të durojë pasojat negative për shkak të lajmërimit të rasteve të korrupsionit, dhënies së dëshmive para organeve kompetente ose ofrimin e dëshmive në procesin në të cilin hetohet rasti i diskriminimit"*. I njëjti nen përcakton se: *"Personat janë të mbrojtur nga çfarëdo lloj i të vepruarit ose pasojave të dëmshme si rezultat i denoncimit ose procesit i cili bëhet për shkak të shkeljes së parimeve të jo diskriminimit"*.⁹

Ndalimi i viktimizimit ka rëndësi të veçantë për denoncimin, inicimin dhe mbajtjen e procesit kundër diskriminimit. Me këtë i jepet mundësi shtesë mbrojtjes së viktimave të viktimizimit dhe është i theksuar gjykimi dhe papranueshmëria e sjelljes diskriminuese, meqë frika nga pasojat negative të denoncimit të diskriminimit është një nga pasojat më të mëdha për realizimin e efekteve të mbrojtjes.

Segregimi është formë e diskriminimit e cila nënkupton „*çdo akt, veprim ose mungesë të veprimit, me të cilët kryhet ndarja ose diferencimi i dhunshëm dhe sistematik i personave në bazë të ndonjëres nga vetitë personale*“.¹⁰

Segregimi është i rrezikshëm, sepse përjashton dhe izolon personat dhe grupet dhe vështirëson integrimin e tyre në shoqëri. Është një nga format më të këqija të diskriminimit dhe paraqet shkelje serioze të të drejtave të njeriut.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër diskriminimit në arsim nga viti 1960, si diskriminim në arsim nënkupton „*dallimin, përjashtimin, kufizimin apo privilegjin i cili, i bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, gjininë, gjuhën, religjionin, bindjen politike apo tjetër, prejardhjes nacionale apo sociale, kushteve ekonomike apo lindjes, ka për qëllim ose rezultat anulimin ose zvogëlimin e të vepruarit të barabartë në arsim, e në veçanti në mënyrë që themelohen ose mbahen sistemet ose institucionet e ndara arsimore për personat ose grupet e personave*“.¹¹

Segregimi në procesin e edukimit dhe arsimit ekziston kur në kundërshtim me ligjin dhe të drejtën për përzgjedhje formohen paralelet e veçanta, të bazuara në statusin shoqëror, etik dhe ekonomik të nxënësve ose përkatësisë në ndonjë grup pakicë, mosnjohjen e gjuhës në të cilën zhvillohet arsimi dhe të ngjashme. Më së shpeshti i prek fëmijët Romë dhe fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, dëmton barazinë e të drejtës në arsim dhe kontribuon marginalizimin e mëtejshëm të fëmijëve që i takojnë grupe të ndjeshme. Për shembull, *kur Romët ndahen në paralele të veçanta me arsyetim se nuk e dijnë mjaftueshëm gjuhën e shumicës që me nxënësit e*

9 Njëjtë

10 Njëjtë

11 Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim, e miratuar në seancën e 11 të Konferencës së Përgjithshme të Organizatave të Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë, me 14 dhjetor 1960.



tjerë pa vështirësi ta përcjellin mësimin. Ose, kur në objektet e shkollave të rregullta fëmijët ndahen në paralele të veçanta, dhe parandalohen të shfrytëzojnë hapësirat e përbashkëta siç janë këndet e lojërave, bibliotekat shkollore, mezat, etj.

Shembulli më i njohur i segregimit si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut është sistemi i aparteidit në Afrikën e Jugut, por edhe fenomeni në rajon „dy shkolla nën një çati“ i cili ekziston në Bosnje dhe Hercegovinë, e ku në të njëjtën shkollë arsimohen nxënësit e dy grupeve etike – Boshnjakët dhe Kroatët me ndarje fizike, me hyrje të veçanta në ndërtesën shkollore, dhe punojnë sipas planeve dhe programeve të ndryshme (të Bosnjës dhe të Kroacisë).

Në edukim dhe arsim sistemi i arsimit mbanë rolin kyç për kulturën e dialogut, kuptimin e të drejtave të njeriut dhe tolerancën, e cila mund të parandalojë shfaqjen e gjuhës së urrejtjes.

Me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit përcaktohen edhe **format e tjera të veçanta të diskriminimit:**

- *Diskriminimi në përdorimin e objekteve dhe sipërfaqeve me shfrytëzim publik*

Shembuj: biblioteka publike/e qytetit është e pa qasshme për personat me invaliditet; shkolla nuk ka tualete publike të përshtatura për shfrytëzim nga personat me invaliditet që krijon vështirësi për qëndrimin e papenguar në institucionin arsimor dhe ndjekjen e mësimin.

- *Diskriminimi në qasjen e të mirave, shërbimeve në sektorin publik dhe privat dhe mallrave*

Shembull: djaloshi me shikim të dobët nxirret jashtë nga restoranti sepse ishte i shoqëruar nga qeni guidë.

- *Diskriminimi sipas gjendjes shëndetësore*

Shembull: djali i infektuar nga virusi HIV ç' regjistrohet nga shkolla pas protestimit të prindërve të fëmijëve të klasës.

- *Diskriminimi sipas moshës*

Shembull: profesoreshës në moshë nuk i lejohet të shkojë në seminar/aftësim profesional për shkak të „vlerësimit“ të drejtorit se në moshë të saj nuk është më e nevojshme dhe është më mirë të shkojë dikush më i ri.

- *Diskriminimi sipas përkatësisë në ndonjë organizatë politike, sindikale ose tjetër*

Shembuj: drejtoria e shkollës me muaj të tërë injoron kërkesat dhe shkresat e profesorit i cili është anëtarë i sindikatës së arsimit që të pranohet në bisedë lidhur me mësimin e lëndës të cilën ai e ligjëron; drejtori zvogëlon normën e orëve të gjuhës franceze profesoreshës e cila ka rezultate të shkëlqyera në gara, vetëm për

arsye se është anëtare e partisë politike të cilën ai nuk e ka të afërt.

- Diskriminimi në punë

Shembuj: drejtori i shkollës i tha haptazi personit me invaliditet i cili konkurroi në vendin e punës së profesorit në shkollë të mesme se nuk dëshiron ta pranojë për shkak të invaliditetit të tij; kur në intervistë për punë femrës i shtrohet pyetja se a planifikon të ketë fëmijë ose a ka qëllim të martohet.

- Diskriminimi në fushën e edukimit, arsimit dhe aftësimit profesional

Shembull: në një shkollë u morr vendimi që nxënësit Romë nuk mund të jenë anëtarë të parlamentit të nxënësve.

- Diskriminimi racor

Shembull: moshatarët maltretojnë nxënësin Rom duke e detyruar atë të hajë mbeturina nga koshi e plehrave, gjë të cilën ai e kundërshtoi dhe u përlesh me një nga moshatarët. Arsimitarja e dënon për dhunë fizike ndërsa moshatarët të cilët e dhunuan kalojnë pa dënim;

- Diskriminimi sipas religjionit dhe bindjes

Shembull: drejtori i shkollës kërkon nga të punësuarit e religjionit islam të cilët kanë ndërmend të shfrytëzojnë ditët e lira për Bajram që një javë më herët të dorëzojnë kërkesën për mungesën nga puna, edhe pse sipas ligjit kanë të drejtë për ditë të lira për festën e vet fetare pa lejen e askujt.

- Diskriminimi i personave me invaliditet

Shembull: objekti shkollor është i papërshtatshëm për qasjen, qëndrimin dhe lëvizjen e personave me invaliditet.

- Diskriminimi sipas identitetit gjinor, orientimit seksual dhe/ose karakteristikave interseksuale

Shembull: Profesoresha e biologjisë në mënyrë të papërshtatshme dhe diskriminuese flet për personat LGBT, për bashkësitë dhe familjet e gjinive të njëjta, ndërsa nxënësve për homoseksualitetin ju flet si veti e cila nuk bënë pjesë në sjelljet normale duke e barazuar me prirjen për krim, konsumin e alkoolit dhe drogave.



Gjuha e urrejtjes

Sipas dispozitave të Ligjit për Ndalimin e Diskriminimit „gjuha e urrejtjes është çdo formë e të shprehurit të ideve, pohimeve, informatave dhe mendimeve e cila përhap, nxit dhe arsyeton diskriminimin, urrejtjen dhe dhunën kundër personave ose grupeve të personave për shkak të vetisë së tyre personale, ksenofobisë, urrejtjes racore, antisemitizmit ose formave të tjera të urrejtjes të bazuara në jo tolerancë, duke përfshirë edhe jo tolerancën e shprehur në formë të nacionalizmit, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave”.¹²

Në përgjithësi, **gjuha e urrejtjes është çdo i folur ose i shkruar publik me të cilin degradohet, nënçmohet ose përhapet urrejtja ndaj individëve, grupeve të cilët mendohen si të ndryshëm për shkak të disa karakteristikave të veta.**

Sipas definicionit të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës gjuha e urrejtjes mbulon çdo formë të të shprehurit i cili përhap, inciton ose promovon urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose format e tjera të urrejtjes të bazuara në jo tolerancë, duke përfshirë edhe jo tolerancën e shprehur me nacionalizmin dhe urrejtjen etnike, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj pakicave dhe emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje emigruese. Sipas të njëjtit përkufizim, format e tjera të diskriminimit dhe të paragjykimeve, siç janë urrejtja ndaj Romëve, urrejtja ndaj të krishterëve, islamofobia, mizogonia, seksizmi dhe diskriminimi sipas orientimit seksual dhe identitetit gjinor, bëjnë pjesë, po ashtu, në gjuhën e urrejtjes.

Autorja Sandra Koliver gjuhën e urrejtjes e përkufizon si çdo „të folur i cili në mënyrë abuzive (abusive), ofenduese (insulting), të frikshme (intimidating), ngacmuese (harassing) dhe/ose i cili nxit (incites) dhunën (violence), urrejtjen (hatred) ose diskriminimin (discrimination)”.¹³

„Pra, mund të thuhet se në teorinë juridike gjuha e urrejtjes, përkundër të gjithave, ka kuptim relativisht preciz. Ajo është shprehje nga gjuha e përditshme për llojet e ndryshme të të folurit me të cilët përhapen dhe arsyetohen urrejtja, jo toleranca dhe paragjykimet, si dhe ftohet dhe nxitet dhuna ose diskriminimi kundër grupe dhe pjesëtarëve të tyre të caktuar të cilët janë të „ndjeshëm” dhe historikisht të viktimizuar/diskriminuar, të cilët mund të identifikohen sipas racës, prejardhjes nacionale ose etnike, ngjyrës së lëkurës, religjionit, gjinisë, orientimit seksual ose karakteristikave të tjera”.¹⁴

Gjuha e urrejtjes shfaqet në botën reale por edhe në atë virtuale – në internet, në rrjete sociale, përmes shtypit dhe grafiteve, në të folurit publik të politikanëve, të prijësve fetar

12 Njëjtë

13 The Article 19 (ed. Sandra Coliver): Striking a Balance - Hate Speech, Freedom of Expression and Non-discrimination, University of Essex, 1992.

14 Vesna Alaburiq, Kufizimi i "gjuhës së urrejtjes" në shoqërinë demokratike – aspektet teorike, ligjore dhe praktike, Hrvatska pravna revija, Zagreb, 2003.

dhe të personave publik. **Atëherë kur nxitet dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë bëhet thirrja në dhunë dhe urrejtje ndaj dikujt i cili dallon, është i ndryshëm, përfaqësues „i atyre të tjerëve“ kemi të bëjmë me gjuhën e urrejtjes.**

Term i afërt me *gjuhën e urrejtjes* është *krimi nga urrejtja*, i cili përcaktohet si çdo formë e dhunës dhe veprës penale e cila është kryer ndaj personit apo grupit të personave për shkak të karakteristikave reale dhe/ose të supozuara, ndërsa në formë të dhunës fizike, verbale dhe psikike, ose kërcënimeve të cilët personi ose grupi i personave i vuan vetëm për arsye se i takon grupit të caktuar pakicë/të ndjeshme. **Gjuha e urrejtjes lind dhunën nga urrejtja si të shprehurit më brutal të diskriminimit dhe të dhunës së shkaktuar nga jo toleranca.**

Gjuha e urrejtjes është i kundërt me lirinë e shprehjes/të folurit gjegjësisht gjuha e urrejtjes për dallim nga liria e shprehjes shemb vlerat e shoqërisë demokratike, ndërprejnë dialogun. E drejta e lirisë së shprehjes është e drejtë themelore e njeriut dhe ka rëndësi të madhe për individin dhe shoqërinë në tërësi. **Por, liria e të shprehurit përfundon atëherë kur me të folur fillojmë të propagandojmë apo nxisim urrejtjen, jo tolerancën, të frikësojmë, përqeshim dhe nënçmojmë, të kërcënojmë ose avokojmë kufizimin e të drejtave dhe lirive të njerëzve të tjerë duke përdorur dhunën.**

Jo çdo i shprehur i ideve dhe mendimeve me të cilët nuk pajtohem ose nuk na përshtaten, përbëjnë kritikë të ashpër dhe satirë, është gjuhë e urrejtjes. Gjersa i foluri i cili na u tha, ose ne ia themi të tjerëve, nuk nxit urrejtjen ose diskriminimin ndaj ndonjë grupi ose individi për shkak të karakteristikave personale nuk bëhet fjalë për gjuhë të urrejtjes. Zakonisht thuhet se aty **ku fillon gjuha e urrejtjes përfundon liria e shprehjes.**

Gjuha e urrejtjes në arsim ndodh në shumë mënyra: duke shkruar mesazhe diskriminuese në muret e shkollave, klasës ose në afërsi të shkollës, duke ftuar në urrejtje dhe dhunë ndaj ndonjërit prej pjesëtarëve të sistemit arsimor për shkak të karakteristikës ose përkatësisë së tij. Për shembull: në mur të ndërtesës shkollore është shkruar grafiti *Thika, teli, Srebrenica!*, ose grafiti me mesazh *Vrisni dhe preni që pederasti të ekzistojë!* ose *Magjypëve thikë në fyt!* Ose, në një kopsht për fëmijë i cili mban emrin e Ana Frank dhe gjendet në periferi të Parisit pak kohë më parë është shkruar grafiti me simbolet e nazizmit dhe mesazhin: *Ndaloheh Hebrejtë!*

Gjuha e urrejtjes ndonjëherë mund të plasohet edhe përmes revistave shkollore, rrjeteve sociale dhe ueb faqeve të shkollës dhe përmbajtjeve të tjera të cilët krijohen dhe shfrytëzohen në procesin arsimor, si dhe përmes tubimeve të ndryshme, tribunave, ngjarjeve në shkollë ose nën organizimin e shkollës. Për shembull: në gazetën shkollore u publikua teksti i cili transmeton intervistën me muzikantin e njohur i cili promovon homofobinë. Ose, kur nxënësit gjatë procesit arsimor publikisht shprehin idetë, informatat dhe mendimet me të cilët ftohet në trajtim jo të barabartë, dhunë dhe urrejtje ndaj personit ose grupit të personave për shkak të ndonjë vetie të tyre personale. Për shembull: *profesoresha e shkollës në profilin e vet në Facebook ka publikuar statusin në të cilin thotë se personat LGBT duhet të heshtën në çdo mënyrë sepse përhapin sëmundje.*



Format e rënda të diskriminimit

Disa sjellje diskriminuese, ose forma të diskriminimit janë veçanërisht të rrezikshme për shoqëri. Këto forma të diskriminimit janë në veçanti të përmendura edhe në Ligj dhe janë kualifikuar si **raste të rënda** të të vepruarit të palejuar dhe kërkojnë reagim më të ashpër të të gjithë pjesëmarrësve në shoqëri të cilët kanë rol në parandalimin dhe reagimin ndaj diskriminimit, në veçanti të gjykatave dhe institucioneve speciale.

Diskriminimi i shumëfishtë ose i kryqëzuar ngjanë kur personi ose grupi janë të diskriminuar, gjegjësisht janë të ekspozuar ndaj të vepruarit ose trajtimit të barabartë në bazë të disa karakteristikave personale. Për shembull, *vajza Rome e cila është person me invaliditet mund të diskriminohet trefish sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe invaliditetit*. Ndonjë person mund të diskriminohet sipas vetisë personale në situata të ndryshme kohore dhe hapësinore. Për shembull, *nxënësja Rome me invaliditet është e diskriminuar sipas invaliditetit, sepse nuk ka qasje në objektet e institucioneve arsimore në vendin ku banon. Sipas përkatësisë etnike ajo është e diskriminuar atëherë kur nuk rrugë i thonë komente raciste*. Diskriminim tjetër i shumëfishtë është kur personi është i diskriminuar sipas disa karakteristikave personale njëkohësisht, që e ndërlikon peshën e diskriminimit, gjegjësisht krijon pengesa shtesë për qasje në arsim.

Diskriminimi i përsëritur ngjanë disa herë ndaj të njëjtit person. Për shembull: *nxënësi Rom është refuzuar gjatë regjistrimit në tre shkolla të mesme në qytetin në të cilin jeton*. Ekziston edhe diskriminimi i cili ngjanë në periudhën më të gjatë kohore ndaj personit ose grupit të personave të njëjtë (**diskriminimi i zgjatur**). Për shembull: *me vite diçka asgjë nuk ndërmerret që qasja në shkollë të përshtatet për nxënësit me invaliditet*.

Diskriminimi i propaganduar përmes mediave publike, si dhe shkrimi apo shfaqja e përmbajtjeve dhe simboleve me përmbajtje diskriminuese në vendet publike. Për shembull: *në gazetën ditore publikohet teksti autorial i profesorit të universitetit i cili personat LGBT i quan njerëz të sëmurë dhe kërkon ndalimin e afirmimit të të drejtave të tyre*.

Diskriminimi i cili në veçanti ka **pasoja të rënda për personin e diskriminuar, grupin e personave ose për pronën e tyre**. Ky është rasti i krimeve nga urrejtja të cilët mund të kenë formën e dhunës së rëndë fizike ndaj përfaqësuesve të grupeve të caktuara, siç është, për shembull, *rrahja dhe shaktimi i lëndimeve të rënda fizike përfaqësuesit të popullatës LGBT, ose përfaqësuesit të popullatës Rome*.



Kur bërja e dallimit nuk është diskriminim – masat e veçanta ose të aksionit afirmativ

Jo çdo bërje e dallimit, gjegjësisht trajtim ndryshe është diskriminim. Praktika e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut tregon se nëse qëllimi dhe pasojat e trajtimit të pabarabartë janë të paarsyeshme mund të flasim për diskriminim. Ndërsa dallimi është i lejuar dhe i arsyeshëm atëherë kur, bie fjala, gjatë punësimit kërkohen kualifikime të veçanta profesionale në pajtim me kërkesat e pozicionit të punës i cili është specifik. Kjo situatë në mënyrë më të përafërt është definuar me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit në pjesën e cila ka të bëjë me diskriminimin në fushën e punës: „Nuk konsiderohet diskriminim bërja e dallimit, përjashtimi ose dhënia e përparësisë për shkak të natyrës së punës së caktuar tek e cila vetia personale e personit paraqet kusht real dhe vendimtarë për kryerjen e punës, nëse qëllimi që dëshirohet të arrihet me këtë është i arsyeshëm dhe nëse kushti është proporcional, si dhe ndërmarrjen e masave mbrojtëse sipas disa kriterëve të personave nga paragrafi 1 i këtij neni“¹⁵

Aksioni afirmativ është lloj i diskriminimit i cili është socialisht i dëshirueshëm i zbatueshëm në sisteme dhe shoqëri të ndryshme kur grupit të caktuar të njerëzve duhet mundësuar që gradualisht të arrijnë barazinë formale, e pastaj edhe thelbësore dhe inkuadrimit në shoqëri. Aksioni afirmativ quhet edhe **trajtim preferencial** ose **diskriminim pozitiv**.

Shembull i aksionit afirmativ janë *masat nxitëse për regjistrimin e fëmijëve rom në shkolla në mënyrë që të përmirësohet statusi dhe arrijtet e tyre arsimore dhe me këtë të krijohet baza për mundësi më të mira punësimi, integrimin më të plotë në shoqëri, etj.* Këto masa ndërmerren në mënyrë që të përmirësohet statusi shoqëror i grupeve të caktuara të cilat në periudhë më të gjatë ishin të marginalizuara, siç janë femrat, personat me invaliditet dhe Romët. Me zbatimin e tyre tejkalohet deprivimi shoqëror i grupeve të caktuara dhe krijohen mundësit që më shpejt dhe më lehtë të mbërrinin deri tek pozitat e njëjta fillestare nga të cilat në mënyrë të barabartë, me anëtarët e tjerë të shoqërisë, mund të arrijnë avancim në arsim, punësim dhe statusin e përgjithshëm socio – ekonomik. Edhe një shembull i kësaj mase është edhe *sistemi i kuotave dhe rregulli që çdo i treti vend në listën e kandidatëve për këshilltarë dhe deputetë i takon femrës, duke tentuar në këtë mënyrë të sigurohet përfaqësimi më i madh i femrave në politikë.*

Në legjisllacioni malazez këto masa quhen masa të veçanta, ndërsa janë të definuar



me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit si „dispozitat dhe masat e veçanta të dedikuara për krijimin e kushteve për arritjen e barazisë nacionale, gjinore dhe të përgjithshme dhe mbrojtjen e personave të cilët për çfarë do lloj arsye janë në pozitë të pabarabartë mund të miratohen, gjegjësisht hartohen dhe zbatohen në kuadër të kompetencave të veta nga organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, organet e njërive të vetëqeverisjeve vendore, ndërmarrjet publike dhe personat e tjerë juridik të cilët ushtrojnë kompetenca publike, si dhe personat e tjerë fizik dhe juridik. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen në proporcion me nevojat dhe mundësitë dhe zgjasin deri në arritjen e qëllimeve të cilët u përcaktuan me këto masa”.¹⁶

Sipas njërit nga përkufizimet „masat e veçanta janë lehtësira specifike me të cilat personave me një karakteristikë të veçantë, e cila mund të jetë bazë për diskriminim, i mundësohet pjesëmarrja e barabartë në jetën publike, hiqen pabarazitë ekzistuese ose iu sigurohen të drejtat të cilat më herët nuk i kishin. Masat e veçanta zbatohen përkohësisht për të realizuar barazinë reale dhe nuk shihen si diskriminim. Masat e veçanta duhen të kenë për qëllim realizimin e qëllimit legjitim”.¹⁷

Aksioni afirmativ është kategori kushtetuese: „nuk do të vlerësohen si diskriminim dispozitat dhe vendosja e masave të veçanta të cilët janë të drejtuara në krijimin e kushteve për realizimin e barazisë nacionale, gjinore dhe të përgjithshme dhe mbrojtjen e personave të cilat mbi çfarë do baze janë në pozitë të pabarabartë. Masat e veçanta mund të zbatohen vetëm gjersa nuk realizohen qëllimet për të cilët janë ndërmarrë”.¹⁸

Mirëpo, **gjatë zbatimit të këtyre masave duhet pasur kujdes që të jenë krijuar të gjithë parakushtet në mënyrë që këto masa të arrijnë efektin e pritshëm.** Pa planifikim të kujdesshëm dhe zbatim konsekuent këto masa mund të humbin kuptimin e vet madhe edhe të kontribuojnë në thellimin e mëtejme të diskriminimit. Të gjithë pjesëmarrësit e procesit arsimor, para së gjithash, duhet të jenë të njoftuar me këto masa, duhet të ekzistojnë mënyrat precize dhe të harmonizuara të zbatimit dhe vetëdija e forcuar e pjesëmarrësve për nevojën dhe arsyen e zbatimit të këtyre masave.

Zbatimi i masave të aksionit afirmativ është proces kompleks i cili duhet mirë të planifikohet dhe të përcillet në mënyrë që të jap rezultate të pritshme.

Kjo në veçanti ka të bëjë me arsimin, sepse arsimit është parakusht i integritetit dhe lëvizshmërisë sociale. Nëse masat ekzistuese të aksionit afirmativ fëmijëve dhe të rinjve romë i mundësojnë regjistrimin në shkollë me fitimin e bursës për shkollim, por zbatohen pa kritere të qarta dhe respektim konsekuent të tyre atëherë ato shndërrohen në të kundërtën e vet. Në këtë mënyrë thelbi i aksionit afirmativ nuk

16 Njëjtë

17 Udhëzuesi për diskriminim dhe mobing në vendin e punës, Prof. Dr. Sc. Mario Vinković, Zagreb <https://www.zagreb.hr/UserDocImages/arhiva/Priru%C4%8Dnik%20o%20diskriminaciji%20i%20mobingu%20na%20radnom%20mjestu.pdf>

18 Kushtetuta e Malit të Zi, Fletorja Zyrtare, nr. 1/2007 dhe 38/2013 – Amandamentët I-XVI



është respektuar, prandaj krijohet hendeku në mes nxënësve romë dhe jo romë për shkak të ndjesisë së padrejtësisë. Nga ana tjetër, bie motivimi i Romëve të rinj, sepse pa kriter fitojnë bursat, nuk përpiqen dhe nuk punojnë në arsim duke e ditur se do ta kalojnë klasën dhe prandaj nuk arrijnë sukses të konsiderueshëm arsimor dhe këto masa mbesin pa efekt.

Përgjegjësia për suksesin e zbatimit të aksionit afirmativ është në administratat e shkollës dhe kuadrot arsimuese që masat t'i zbatojnë duke u kujdesur që të ekzistojnë procedurat, që të rinjtë e përfshirë me masa me të vërtetë të përparojnë, që të zhvillohet motivimi për punë dhe marrjen e dijes, që vazhdimisht të bashkëpunojnë me prindërit e tyre, duke mundësuar asistencë të dobishme në mësim... Asnjë masë nuk do të japë rezultat nëse nxënësit nuk morën një standard të caktuar të dijes i cili paraqet bazën për përparim përmes cikleve arsimore. Nëse aksioni afirmativ nuk zbatohet me kritere të qarta dhe nëse nuk bëhen përpjekjet që nxënësit të ndihmohen me të vërtetë të marrin dije dhe të përmirësojnë aftësitë e veta, atëherë kemi të bëjmë me diskriminim, e jo përkrahje.



Kush janë diskriminuesit dhe viktimat e tyre?

Çdo kush mund të jetë viktimë e diskriminimit, njëjtë si çdo kush është diskriminues potencial, ndërsa diskriminimi mund të ngjajë në çdo sferë të jetës, gjegjësisht të shoqërisë (sfera private ose publike). Individit, grupi i cili ndanë ndonjë veti personale, por edhe personi juridik mund të jenë viktimat e diskriminimit.

Individi mund të jetë viktimë e diskriminimit në arsim nëse për shkak të ndonjë vetie personale iu ndalu regjistrimi në shkollë. Grupi i personave, siç janë personat me invaliditet janë të diskriminuar nëse objekti shkollor nuk është i aksesueshëm për to. Personi juridik është institucioni, shkolla. A mundet shkolla të jetë e diskriminuar? Mundet. Nëse komuniteti lokal nuk dëshiron të bashkëpunojë ose nuk përkrah shkollën për arsye se atë e ndjekin më së shumti nxënësit romë.

Në secilin nga marrëdhëniet e mundshme në mes pjesëmarrësve të procesit edukativo – arsimor mund të ngjajë diskriminimi.

Diskriminimi në arsim

Diskriminimi në fushën e edukimit, arsimit dhe aftësimin profesional është i ndaluar me Ligjin për Ndalimin e Diskriminimit: „Me Diskriminim në fushën e edukimit, arsimit dhe aftësimin profesional kuptohet vështirësimi ose pamundësimi i regjistrimit në institucionin edukativo – arsimor dhe institucionin e arsimit të lartë dhe i përzgjedhjes së programit arsimor në të gjithë nivelet e edukimit dhe arsimit, përjashtimi nga këto institucione, vështirësimi dhe mohimi i mundësisë së ndjekjes së arsimit dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e tjera edukuese, gjegjësisht arsimore, ndarjen e fëmijëve, nxënësve/eve, atyre që ndjekin arsimin dhe studentëve/eve, keqtrajtimi ose diferencimi i paarsyeshëm ose trajtimi i pabarabartë i tyre, sipas ndonjëres nga bazat nga neni 2 paragrafi 2 i këtij ligji (vetitë personale)“.¹⁹

Ligji i përgjithshëm për arsimin po ashtu ndalon diskriminimin. „Në institucion nuk lejohet: dhuna fizike, psikike dhe sociale, keqtrajtimi dhe mospërfillja e fëmijëve dhe nxënësve, dënimi dhe ofendimi fizik i personalitetit, gjegjësisht keqpërdorimi seksual i fëmijëve dhe nxënësve ose i të punësuarve dhe çdo formë tjetër e diskriminimit sipas këtij ligji“.²⁰

Me ligj të njëjtë garantohet edhe parimi i disponueshmërisë dhe barazisë në aksesin e arsimit: „Me ndarjen e institucioneve në territorin e Republikës i sigurohet qytetarëve disponueshmëria e njëjtë e ndjekjes së arsimit dhe edukimit“²¹ gjegjësisht „Shtetasit e Malit të Zi janë të barabartë në realizimin e të drejtës në arsim, pavarësisht përkatësisë nacionale, racës, gjinisë, gjuhës, religjionit, prejardhjes sociale, invaliditetit ose veti tjetër personale. Shtetasit e huaj të cilët janë me banim të përkohshëm ose të përhershëm në Mal të Zi, janë të barabartë në realizimin e të drejtës në arsim me shtetasit e Malit të Zi, në pajtim me ligjin e veçantë“²².

Arsimi luan rolin kyç në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të sistemit demokratik dhe shoqërisë qytetare të cilët bazohen në vlerat e të drejtave të njeriut dhe të antidiskriminimit.

Me qëllimet e veta, përmbajtjen dhe metodat e punës, përveç marrjes së dijes dhe të aftësive nga fushat e ndryshme, arsimi synon formimin e kulturës antidiskriminuese dhe të

19 Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 046/10, 040/11, 018/14, 042/17

20 Ligji i Përgjithshëm për Arsim dhe Edukim, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 64/2002, 31/2005, 49/2007, 4/2008 dhe ligji tjetër – 21/2009 dhe ligji tjetër - 45/2010, 40/2011 – dhe ligji tjetër, 45/2011, 36/2013, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi 39/2013 dhe 44/2013 dhe 47/2017, shih Vendimi i GJK MZ 12/2011, shih Vendimi i GJK MZ 23/2011.

21 Njëjtë

22 Njëjtë



të drejtave të njeriut tek të rinjtë. Përveç mësimit për të drejtat e njeriut përmes koncepteve, konventave dhe ligjeve, sistemi i arsimit me funksionimin e tij të përgjithshëm duhet të synojë formimin e personalitetit tek të rinjtë që të kuptojnë, adoptojnë dhe praktikojnë vlerat dhe parimet antidiskriminuese. Përgjegjësia e të punësuarve në arsim nënkupton, përveç mbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve profesionale, edhe respektimin e personalitetit njerëzor, refuzimin e diskriminimit ndaj kolegëve, nxënësve dhe prindërve të tyre, si dhe pjesëmarrësve të tjerë në procesin e arsimit.

Pjesëmarrësit e procesit të arsimit kanë role dhe përgjegjësi të shumta në zhvillimin e kulturës antidiskriminuese. Kjo kërkon edhe kyçjen aktive dhe përkrahjen e pjesëmarrësve të jashtëm, gjegjësisht të shoqërisë në tërësi. Edukimi për kulturën antidiskriminuese është çështje e konsistencës dhe prandaj është e rëndësishme që të vepruarit e të gjithë aktorëve të shoqërisë të cilët ndikojnë në shoqërimin dhe edukimin e të rinjve, me përkushtim të njëjtë, të jetë i drejtuar në arritjen e qëllimeve të arsimit si veprimtari me interes më të gjerë shoqëror.

Qëllimet e arsimit janë të formuluarat dhe bazohen në parimet antidiskriminuese me të cilët krijohet mundësia për zhvillimin e gjithanshëm të individit, pavarësisht në gjininë, moshën, prejardhjen sociale dhe kulturore, përkatësinë nacionale dhe religjioze dhe cilëndo veti/karakteristikë, gjegjësisht përkatësi personale. Po ashtu, detyra e arsimit është që të rrisë vetëdijen, nevojën dhe aftësinë tek të rinjtë që aktivisht të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor, mjedisit jetësor të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, zhvillimin e shoqërisë në frymën e promovimit dhe kultivimit të multietnicitetit dhe diversitetit.

Aktorët ose pjesëmarrësit në procesin e arsimit janë nxënësit dhe profesorët e tyre, administrata e shkollës dhe të punësuarit e tjerë në atë institucion, trupat dhe shërbimet profesionale, prindërit, por edhe aktorët jashtë sistemit të cilët mund të ndikojnë në të. Në marrëdhëniet në mes aktorëve krijohen dhe zhvillohen forma të ndryshme të marrëdhënieve, duke përfshirë këtu edhe diskriminimin. **Të gjithë mund të jenë viktima të diskriminimit, pra edhe ato që me veprimet e veta e bëjnë.**

Mirëpo, **asnjë nga aktorët e procesit edukativo – arsimor nuk duhet t'i ekspozohet diskriminimit**, përkatësisht dhunës fizike, psikike dhe sociale, keqtrajtimit seksual ose ndonjë formë tjetër të të vepruarit diskriminues i cili nënçmon personalitetin, me vëmendje të veçantë ndaj nxënësve të cilët nuk duhet të lihen pas dore ose t'i ekspozohen cilësdo formë të rrezikut për integritetin fizik apo personal.

Nëse në sistemin arsimor, prej nivelit më të ulët, nuk i kushtohet vëmendja e veçantë edukimit me të cilin do të de-konstruktohen paragjykimet dhe stereotipat, nuk do të ngjajnë përparimet e konsiderueshme në luftë për ç' rrënjosjen e diskriminimit në shoqëri. Secili pjesëmarrës në procesin e arsimit është i obliguar të respektojë të drejtën për ndalimin e diskriminimit dhe respektimin e barazisë në fushën e realizimit të të drejtave dhe obligimeve, siç është përcaktuar me ligjet vendase, dokumentet dhe standardet ndërkombëtare.

Format e ndryshme të diskriminimit në arsim

Ndalimi i diskriminimit është ideali i shoqërisë moderne e cila synon realizimin e parimit të barazisë dhe barabarësisë në të gjithë sferat e jetës shoqërore, duke përfshirë edhe arsimin. Ndërsa arsimi është kanali kyç i lëvizshmërisë sociale, dhe nëse bazohet në parimet e shanseve dhe mundësive të barabarta atëherë është në shërbim të mirëqenies së përgjithshme të shoqërisë.

Diskriminimi në arsim mund të shfaqet në çdo segment të procesit: gjatë regjistrimit në institucionin arsimor, në procesin e formimit dhe funksionimit të organeve dhe trupave të nxënësve dhe të tjerë shkollorë, gjatë hartimit dhe miratimit të planeve dhe programeve arsimore, në komunikim të përditshëm dhe në marrëdhënie të ndërsjellët në mes pjesëmarrësve të procesit, gjatë procesin arsimor, në përmbajtjen e librave shkollor, në procesin e punësimit, të realizimit të të drejtave për përmirësim dhe aftësim profesional, në menaxhimin e shkollës, etj.

Diskriminimi gjatë punësimit në institucionet arsimore paraqitet kur është prishur barazia e mundësisë për punësim dhe gëzimit të të drejtave të cilët rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe janë të lidhura me punën. Mundësia e diskriminimit ekziston edhe në fushën e aftësimin profesional dhe përparimit me kushte të njëjta, si dhe pjesëmarrjen në punën organeve profesionale dhe administruese në shkollë. Për zgjidhjen e këtyre rasteve konkrete adresa e parë për ndihmë është Inspektorati i Punës i cili kujdeset për ligjshmërinë e procesit të arsimit dhe realizimin e të drejtave në punë dhe në bazë të punës. Në varësi të peshës së rastit, në dispozicion janë edhe organet tjera, siç është Ministria e Arsimit, Institucioni i Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, si dhe mbrojtja gjyqësore.

Shembull: drejtori i shkollës nuk dëshiron të punësojë personin me invaliditet në vendin e punës të profesorit për shkak të gjendjes së tij/saj, edhe pse bëhet fjalë për kandidatin më të mirë i cili është lajmëruar në konkurs. Në vend të tij/saj punësohet kandidati/ja me referenca më të dobëta i/e cila nuk ka invaliditet. Po ashtu, diskriminim do të ishte nëse drejtori i institucionit arsimor gjatë bisedës për punë e pyet kandidatin për përkatësinë politike, ose e punëson kandidatin për shkak të përkatësisë politike e jo në bazë të referencave formale dhe të kontrollueshme dhe të cilat ky vend punës i kërkon.

Po ashtu, **diskriminimi në administrimin e shkollës dhe gjatë vendimmarrjes** është një nga format specifike të diskriminimit në arsim. Ngjanë kur nxënësit, prindërit



e tyre, të punësuarit në shkollë si përfaqësues të grupit të caktuar ose për shkak të ndonjë vetie personale përjashtohen nga puna e trupave shkollor (të nxënësve, profesionale, këshillave të prindërve, etj.), nga planifikimi dhe realizimi i planeve dhe programeve shkollore, nga vetëvlerësimi i shkollës dhe të analizave të tjera të cilët janë të nevojshme në mënyrë që plani dhe programi i shkollës të harmonizohet me nevojat e të gjithë pjesëmarrësve dhe synimeve të procesit edukativo – arsimor (kjo është në veçanti e rëndësishme për krijimin e kushteve që shkolla të jetë inkluzive).

Nxënësit mund të jenë të diskriminuar edhe atëherë kur i cungohet dhe kufizohet e drejta në pjesëmarrje gjatë vendimmarrjes për çështjet me rëndësi për nevojat dhe interesat e tyre përmes, për shembull, punës së trupave të nxënësve e për shkak të ndonjë vetie apo përkatësie personale, ose kur nxënësit nuk janë në mënyrë të barabartë të kyçur në hulumtimet vendase dhe ndërkombëtare për cilësinë e arsimit. Për shembull: *nxënësit Romë nuk janë kyçur në punën e Parlamentit të nxënësve, ose janë kyçur por pa mundësi të pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje.*

Në mënyrë që procesi i arsimit të zhvillohet në mënyrën e cila siguron barazi dhe gjithë përfshirje nevojitet që, në mënyrë të barabartë, të kyçen fëmijët, prindërit e tyre dhe të punësuarit në shkollë pavarësisht në përkatësinë e tyre ose vetitë personale. Vetëm vendimmarrja e barabartë mund të kontribuojë arritjen e efekteve të plota të arsimit dhe funksionimit të mirë të institucioneve arsimore.

Diskriminimi në respektimin e rregullave shkollore lajmërohet: nëse të gjithë nxënësit e procesit arsimor nuk janë informuar në kohë dhe detajisht për të gjithë të drejtat dhe obligimet të cilat i takojnë sipas ligjit; nëse të gjithë nxënësit e procesit arsimor nuk marrin pjesë njëjtë në formulimin dhe miratimin e rregullave të veçanta shkollore, sepse disave për shkak të vetive dhe përkatësisë personale iu pamundësua kjo e drejtë; nëse rregullat dhe sanksionet për mos respektimin e tyre nuk zbatohen njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit e procesit arsimor, por në mënyrë selektive në varësi nga vetitë dhe përkatësia e tyre personale; nëse tolerohet dhe nuk veprohet në rast të të sjellit të palejuar ndaj nxënësve të caktuar për shkak të vetisë së tyre personale. Shembull: *është veprim i palejueshëm dhe diskriminues nëse vëmendja e njëjtë nuk i kushtohet respektimit të rregullave dhe obligimeve shkollore nga ana e të gjithë nxënësve, kështu që në mënyrë të plotë injorohet situata e numrit të madh të mungesave nga shkolla të nxënësve romë dhe nuk ndërmerren masat që të vërtetohet arsyeja dhe të përmirësohet situata, me qasje të gabuar se kjo është sjellje normale dhe e pritshme e nxënësve romë.*

Diskriminimi në ofrimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe dhuna në shkollë shfaqet nëse institucioni arsimor nuk ofron, në baza të barabarta dhe të njëjta, çdo nxënësi të procesit të arsimit mbrojtjen dhe përkrahjen në situatat e dhunës, keqtrajtimit dhe injorimit dhe bënë dallim sipas përkatësisë ose vetisë personale. Me Ligj ndalohet dënimi fizik, nënçmimi dhe ofendimi i personalitetit të nxënësit pavarësisht në përkatësinë ose vetinë personale, ndërsa e njëjta vlen edhe për sjelljen



e papërshtatshme e cila rrezikon integritetin personal dhe fizik të punëtorëve të arsimit në institucion, anëtarëve të strukturave udhëheqëse, me një fjalë të cilindo të punësuar apo pjesëmarrës të procesit arsimor në shkollë.

Diskriminimi mund të shfaqet kur mohohet sjellja dhe të vepruarit diskriminues në shkollë, madje edhe në rastin e dhunës së rëndë, kur ajo fshihet dhe nuk zgjidhet për shkak të vetisë personale ose përkatësisë së viktimës. Po ashtu, diskriminimi ekziston kur tolerohet, nxitet ose arsyetohet të shprehurit e urrejtjes, intolerancës ose të qëndrimeve të hapura diskriminuese nga ana e cilitdo pjesëmarrës të procesit arsimor. Shembull: *Profesoresha i tha nxënësit i cili u ankua në dhunën në mes bashkëmoshatarëve se duhet të ndalojë së sfiduari nxënësit e tjerë me sjelljen e tij „të çuditshme“ dhe të fillojë të sillet në mënyrë normale. Ose, kolegët profesorët ofendojnë dhe nënçmojnë kolegen para nxënësve për shkak të statusit të saj të keq material, ndërsa administrata e shkollës nuk e parandalon këtë lloj të sjelljes. Përkatësisht, prindërit e nxënësve Romë ankohen për diskriminimin e fëmijëve të tyre nga ana e moshatarëve gjë që ju bënë mjedisin jetësor dhe jetën në të të vështirë, por arsimtarët dhe administrata e shkollës nuk reagojnë në mënyrë adekuate duke e karakterizuar situatën si „lojëra fëmijësh“, etj.*

Veçantitë kulturore, gjuhësore dhe të tjera duhet të trajtohen me kujdes, sepse diskriminimi ekziston edhe atëherë kur përmes planeve të punës promovohen vlerat e kulturës së përfaqësuesve të popullatës shumicë, gjersa grupet e tjera mohohen ose injorohen. Përdorimi i gjuhës është çështje relevante kur vlerësohet shkalla e qasjes së njëjtë në arsim të të gjithë nxënësve. Për shembull, *nëse në vendet ku ndonjë komunitet nacional është shumicë nuk mundësohet që nxënësit të kenë mësim në gjuhë amtare. Ose, nëse me programet arsimore injorohen ose nuk përfshihen në mënyrë adekuate temat që kanë të bëjnë me gjuhën, letërsinë, historinë dhe kulturën e komuniteteve nacionale, atëherë të gjithë nxënësit nuk janë në pozitë të barabartë në procesin e arsimit dhe kjo nuk kontribuon në krijimin e mirëkuptimit dhe tolerancës së ndërsjellët. Përkatësisht, kur plani zhvillimor i shkollës dhe plani dhe programi arsimor nuk pasqyrojnë specifikën e komunitetit lokal, e në veçanti kushtet në të cilët jetojnë nxënësit përfaqësues të grupeve vulnerabël.*

Diskriminimi në qasjen e të drejtës në arsim manifestohet përmes moszbatimit të masave të cilat janë të përcaktuara me ligj, e të cilat kanë për qëllim të mundësojnë regjistrimin e nxënësve nga grupet vulnerabël, të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe të nxënësve përfaqësues të pakicave nacionale (zbatimi jo konsekuent ose kundërshtimi i zbatimit të masave nga aksioni afirmativ). Për shembull, *kur nuk sigurohen asistentët në arsim për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.*

Diskriminimi është edhe atëherë kur pjesëmarrësve për shkak të ndonjë vetie personale ose përkatësisë në ndonjë grup i vendosen kushtet shtesë, ose kushtet të cilat nuk janë të parapara me ligj dhe aktet nënligjore, siç janë kërkimi i dokumenteve shtesë



për regjistrim në shkollë, ose në mënyrë automatike për shkak të mos posedimit momental të dokumenteve, siç është certifikata e lindjes ose asaj të shtetësisë, fëmijës nuk i mundësohet regjistrimi në shkollë, edhe pse disa fëmijë (siç janë Romët) kanë vështirësi që këto dokumente t'i marrin në kohë. Shembull është edhe kur nuk jepen vërtetimet për klasën e përfunduar ose të nivelit përfundimtar të arsimit për shkak të ndonjë vetisë personale të nxënësit, me çka vështirësohet qasja dhe kalimi në nivele më të larta arsimore ose punësimi.

Diskriminimi mund të shfaqet edhe gjatë mbajtjes së procesit arsimor dhe të procedurës së vlerësimit të arritjeve të standardit të dijes në procesin edukativo-arsimor. Nëse kriteret dhe pritshmëritë për arritjet e nxënësve të caktuar janë pa arsye dhe paraprakisht ulen për shkak të ndonjë vetie të tyre personale ose përkatësie, sepse në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme supozohet se kapacitetet e tyre për mësimin e lëndës janë më të dobëta, etj. Ose, nëse nxënësve me nevoja të veçanta arsimore i jepen obligime në mësim të cilat nuk janë në pajtim me planin e tyre individual zhvillimor dhe tejkalojnë mundësitë e tyre, gjegjësisht nga ato kërkohet njëjtë si nga fëmijët e tjerë.

Diskriminimi shfaqet edhe kur nxënësit nuk i sigurohet që, pavarësisht nga vetia personale, mbërrin arritje të përgjithshme, nëse nuk i sigurohet përkrahje që të përparojë përmes ofrimit të metodave të ndryshme arsimore, mësimi shtesë dhe përkrahjes në mësim ose nëse vlerësimi i arritjeve nuk është i përshtatur me nevojat e nxënësve dhe përparimin individual. Gjegjësisht, kur shkurtohet plani dhe programi arsimor për nxënësit për shkak të ndonjë vetie të tyre personale në krahasim me nxënësit tjerë (disa tema, leksione hiqen, ose nuk kërkohet nga nxënësi që t'i mësojë, sepse në mënyrë të paarsyeshme supozohet se për fëmijët nga grupet e caktuara ato janë shumë të vështira). Më tej, nëse nuk zbatohen kriteret e veçanta të parapara me ligj për vlerësimin e arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, ose të nxënësve të talentuar dhe kur mungon përcjellja individuale e arritjeve dhe zhvillimit. Zbatimi i paarsyeshëm i kriterëve më të ulëta gjatë vlerësimit të disa nxënësve për shkak të vetisë së tyre personale shkakton nivel më të ulët të arritjeve arsimore. Nëse nxënësve i falen notat kaluese që të kalojnë në klasën tjetër, e që nuk kanë arrit as një minimum të standardit të dijes, i rrezikohet përherë përparimi në mësim dhe në arritjet në vazhdim të shkollimit, përjetësohet pozita e pafavorshme në mësim dhe pastaj i vështirësohet punësimi. Për shembull: *nxënësit e kombësisë Rome përjashtohen nga mësimi i gjuhës angleze, me arsyetim se lënda është shumë e vështirë dhe "e pa mësueshme" për ato. Ose, për nxënësit Romë vendosen kriteret e veçanta, më pak të vështira, që rezultojnë me faktin se këtyre fëmijëve i pamundësohet marrja e dijes me cilësi të duhur, të cilën mundësi e kanë nxënësit e tjerë të cilët nuk janë të kombësisë Rome.* E gjitha kjo flet për kompleksitetin dhe vështirësinë e rolit të profesorit dhe të administruesit të institucionit arsimor në parandalimin e diskriminimit dhe plotësimin e qëllimit të arsimit në interes më të mirë, e përmes qasjes së njëjtë dhe të barabartë për të gjithë nxënësit.



Diskriminimi përmes përmbajtjes së librave për mësim sepse librat mund të mos përputhen me zbulimet shkencore dhe në këtë mënyrë të përkrahen dhe të forcohen më tej stereotipat dhe paragjykimet ndaj grupeve të caktuara dhe të drejtave të tyre. Nëse kemi parasysh se qëllimi i arsimit është të zhvillojë vetëdijen për diferenca, barazi dhe interkulturalitet, atëherë është e nevojshme që dija e cila përcillet përmes librave të jetë e bazuar në fakte shkencore, e jo në ligjërimin e përmbajtjeve dhe gjysmë të vërtetave jo shkencore. Shembull: *librat mësimor e paraqesin popullatën LGBT si fenomen patologjik dhe devijim social përkundër zbulimeve shkencore të cilët dëshmuajnë se nuk bëhet fjalë për sëmundje, dhe as devijim të çfarëdo forme. Ose, përmbajtjet e librave shkollor janë plotë stereotipa gjinore në kundërshtim me konceptin e barazisë gjinore të bazuar në arritjet bashkëkohore shkencore.*

Diskriminimi përmes përdorimit të të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve në procesin edukativo – arsimor krijohet në situata kur të dhënat konfidenciale për personalitetin përdoren në mënyrë që ndonjë pjesëmarrës i procesit edukativo – arsimor të jetë në pozitë të pafavorshme. Përgjegjësia në aspektin e parandalimit të diskriminimit në arsim kërkon përkushtim dhe durim, sepse diskriminimi mund të shfaqet në nuanca të shumta dhe të ndryshme. Prandaj është e rëndësishme që gjatë cilitdo aktivitet ose veprim në procesin e arsimit, në fazën e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve arsimore, të shënjestrohen të gjithë situatat potenciale të cilat mund të shkaktojnë trajtim të pabarabartë dhe të parandalohen në mënyrë adekuate. Diskriminimi në arsim vazhdon të lejë pasoja të rënda, në veçanti ndaj personalitetit, si dhe në arsimin dhe jetën e mëtejme të njerëzve të rinj.

Kujt ti drejtohem për ndihmë nëse ndodh diskriminimi – rrjeti i përkrahjes brenda dhe jashtë shkollës

Obligimi qytetarë dhe moral i çdo pjesëmarrësi të procesit të arsimit është që në mënyrë aktive të parandalojë diskriminimin dhe të reagojë ndaj çdo sjellje diskriminuese e cila mund të ndodh, pavarësisht a bëhet fjalë për marrëdhënien në mes nxënësve, nxënësve dhe profesorëve apo nxënësve dhe administratës, profesorëve në mes veti ose me ndonjë aktor tjetër të procesit edukativo – arsimor.

Burimet e brendshme të shkollës të cilët mund të ndihmojnë në parandalimin dhe zgjidhjen e rasteve të diskriminimit

Edhe pse diskriminimi në arsim mund t'i ndodh çdokujt prej pjesëmarrësve të procesit arsimor, nxënësit janë grupi më vulnerabël. Ligji i garanton nxënësve të drejtën e mbrojtjes nga të gjithë llojet e dhunës, diskriminimit, keqtrajtimin dhe injorimit në shkollë, që më hollësisht përcaktohet me statutin e shkollës. Është i rëndësishëm edhe obligimi i nxënësve që të respektojnë personalitetin e shokëve të klasës dhe të shkollës, si dhe personalitetin e profesorëve dhe me to të bashkëpunojnë përmes ndjekjes së rregullt të arsimit, t'i mirëmbahen disiplinës gjatë mësimin dhe rregullave të tjera në shkollë.



Roli i procesit edukativo – arsimor është kyç në parandalimin e diskriminimit. Krijimi i ambientit të sigurt dhe nxitës dhe të atmosferës së bashkëpunimit, tolerancës, respektimit të ndërsjellët dhe komunikimit të hapur në mes aktorëve të procesit arsimor zhvillon sistemin e vlerave pozitive i cili vepron në mënyrë parandaluese ndaj fenomenit të diskriminimit, si në institucionin shkollor, ashtu edhe jashtë tij. Shkolla e cila kultivon kulturën e antidiskriminimit edukon për jetën në shoqëri e cila është përfshirëse dhe kultivon barazinë si parim të funksionimit.

Për të parandaluar diskriminimin, institucionet arsimore dhe të gjithë që punojnë aty janë të obliguar të kultivojnë ndjeshmëri të veçantë dhe të punojnë vazhdimisht në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e tolerancës së të ndryshmes dhe kulturës së respektimit.

Në mënyrë që parandalimi të jetë i suksesshëm secili pjesëmarrës i procesit arsimor duhet të jetë i njoftuar me të drejtat dhe obligimet e veta. Me statutin e shkollës dhe me aktet tjera të cilët rregullojnë funksionimin e institucionit nevojitet, në mënyrë më të saktë, të përcaktohen procedurat në rastet e diskriminimit dhe ndarja e roleve dhe e përgjegjësisë të të gjithë pjesëmarrësve në proces. Institucioni është i obliguar të zbatojë parandalimin përmes programeve dhe zhvillimit të përmbajtjeve në shkollë të cilët promovojnë tolerancës, rëndësinë e kulturës të të drejtave të njeriut dhe vlerave antidiskriminuese. Po ashtu, institucioni duhet të zhvillojë dhe zbatojë programet të cilët nxisin participimin e nxënësve, prindërve në bashkëpunim me arsimtarët dhe administratën e shkollës në përpilimin e rregullave të sjelljes me të cilët promovohet respekti i ndërsjellët. Me qëllim forcimin e parandalimit, institucionet duhet edhe të kyçen, marrin pjesë dhe zhvillojnë projektet dhe trajnimet për marrjen e dijeve dhe aftësive të nevojshme për njohjen, parandalimin dhe të vepruarit në rastet e sjelljes diskriminuese për arsimtarët dhe pjesëmarrësit tjerë të procesit arsimor të cilët punojnë me të rinjtë. Institucioni përgjegjës ndërton dhe zhvillon bashkëpunimin me komunitetin lokal, shoqërinë lokale civile dhe aktorët tjerë si burime jashtë institucionit të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimin e kulturës antidiskriminuese.

Nxënësit kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës aktiv të edukimit dhe arsimit të tyre përmes mundësisë që lirisht të shprehin mendimin për punën e arsimtarëve, të kërkojnë vlerësimin e dijes së tyre nga ana e komisionit gjatë mësimin, të japin vërejtje për notën pas periudhës klasifikuese, vitit mësimor ose në provim, të organizohen përmes njësisë së paraleles dhe parlamentit të nxënësve dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes me rëndësi për interesin e tyre, së bashku me organet profesionale në shkollë.

Fal njësisë së paraleles dhe parlamentit të nxënësve nxënësit zhvillojnë dhe artikulojnë qëndrimin e vet për cilësinë e disa aspekteve të procesit edukativo – arsimor dhe kanë mundësi që zëri i tyre të dëgjohet më lehtë dhe më mirë tek aktorët e tjerë të procesit, profesorët dhe administrata e shkollës.

Nxënësve duhet tu mundësohet që lirisht të shprehin atë çfarë mendojnë, sepse në



këtë mënyrë përherë dhe me sukses formohet vetëdija kritike e cila është parakusht dhe efekt kyç i çdo procesit të rëndësishëm të arsimit. Vetëdija kritike dhe nevoja e përhershme për rishikim, analizë të qëndrimeve, fakteve, mendimeve dhe veprimeve është mekanizmi më i mirë për shpërbërjen e stereotipave dhe paragjytimeve prej ku rrjedh diskriminimi, e pastaj edhe dhuna dhe format tjera të shkeljes së të drejtave të njeriut. Pikërisht liria e plotë e shprehjes, me kufizimet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, kanë rolin preventiv në krijimin e konflikteve, shfaqjen e diskriminimit, shkeljen e të drejtave dhe dhunës në shkollë. Po ashtu, pjesëmarrja e nxënësve në jetën e shkollës dhe trajnimi më i mirë për pjesëmarrjen e mëvonshme aktive në jetën shoqërore.

Për sukses në procesin edukativ arsimor është kyçe që të gjithë pjesëmarrësit e tij të ndjehen të sigurt, të mbrojtur nga shkelja e të drejtave të njeriut dhe diskriminimi. Çdo nxënës ka të drejtë për mbrojtje nga të gjithë llojet e dhunës, diskriminimit, keqtrajtimit dhe injorimit në shkollë. Po ashtu, ndaj nxënësit i cili nuk i plotëson obligimet dhe nuk i përmbahet rregullave shkollore mund të ndërmerren masat edukuese: vërejtja, paralajmërimi dhe përjashtimi nga shkolla. Nëse silltet në mënyrë të papërshtatshme ndaj nxënësve (i drejtohet me fjalë të pista, me kërcënime, provokime ose merr pjesë në përlëshje, etj.) mund të ndërmerren masat e paralajmërimit, ose nëse shkakton jo tolerancën nacionale ose fetare në shkollë, gjegjësisht bënë dhunë psikike, fizike ose gjinore atëherë mund të përjashtohet nga shkolla. Vënien e masave edukuese mund ta iniciojë nxënësi, prindi ose cilido nga të punësuarit në shkollë. Ato jepen duke pasur kujdes interesin më të mirë të nxënësit, me përkrahjen e pedagogut ose psikologut të shkollës, si dhe me mundësinë e ankesës së nxënësit apo të prindërve të tij ndaj vendimit për zbatimin e masave.

Asnjë nxënës nuk mund të jetë i viktimizuar për shkak të shprehjes së mendimit kritik ose ankesës ndaj cilitdo segment të procesit edukativo – arsimor në shkollë. Vendimi për cilendo masë disiplinore ose edukuese është përfundimtare vetëm atëherë kur shteren të gjithë të drejtat për ankesë të cilët janë në dispozicion të nxënësit dhe të prindërve të tij. Çdo veprim i ndryshëm nga ky paraqet shkelje të të drejtave të nxënësit.

Vetëm në ambientin i cili siguron respektimin e personalitetit të çdo individi, i cili është i hapur, inkluziv dhe ofron mundësinë për mësim përmes respektimit të atmosferës, është e mundur të formohen kompetencat e nxënësve të cilët do të jenë të gatshëm që në mënyrë aktive dhe produktive, si qytetarë të përgjegjshëm, të marrin pjesë dhe t'i kontribuojnë komunitetit.

Të gjithë pjesëmarrësit e procesit të arsimit janë të obliguar që të parandalojnë shfaqjen e diskriminimit dhe të formave të tjera të shkeljes të të drejtave të njeriut, sjelljes së ndërsjellët dhe komunikimit dhe promovojnë vlerat e tolerancës dhe mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe solidaritetit. Kur diskriminimi ngjanë të gjithë janë të obliguar të reagojnë dhe në kohë dhe në mënyrë adekuate të procedojnë çdo rasti individual me qëllim zgjidhjen dhe eliminimin e pasojave negative në interesin më të



mirë të nxënësit.

Kur ndodh diskriminimi, janë të shumtë mundësitë e mbrojtjes dhe parandalimit të përkeqësimit të mëtejme të situatës. Zgjidhja e parë të cilën e kanë nxënësit është të bisedojnë me ndonjërin nga profesorët, ose me **kujdestarin e klasës**, ose ti drejtohen **shërbimit psikologjik pedagogjik në shkollë**. Përveç që janë ligjërues dhe përcjellin dijen nga lëndët specifike profesorët njëkohësisht kanë rolin që të ofrojnë përkrahje kur nxënësit ballafaqohen me ndonjë problem, t'i dëgjojnë dhe udhëzojnë si ta zgjidhin çdo vështirësi me të cilën mund të ndeshen gjatë përvetësimit të lëndës, gjegjësisht me shokët e klasës ose të shkollës, arsimtarët dhe administratën. Sipas statutit të shkollës, është obligim i profesorëve që të kujdesen për zgjidhjen e problemeve edukuese dhe arsimore të nxënësve. Pikërisht ky rol i profesorit si ndërmjetës në mes diskriminuesit dhe viktimës mund të jetë shumë i rëndësishëm në gjetjen e zgjidhjeve adekuate në rastin e diskriminimit. Profesori mund të kyçet në zgjidhjen e problemit duke i shpjeguar nxënësve pse sjellja diskriminuese dhe e dhunshme nuk është e lejueshme, pse është e gabuar, cilat pasoja i shkakton, në çfarë mënyre dënohet, etj. Patjetër, profesori mund të vlerësojë se a është rasti individual i tillë që kërkon mënyrë tjetër të zgjidhjes, përmes bashkëpunimit me shërbimin profesional, administratën, prindërit, kolegët, ose ndonjë institucion tjetër jashtë sistemit të përkrahjes të cilin e ofron vet institucioni arsimor, nëse bëhet fjalë për raste më të rënda të diskriminimit. Çdo kush që merr pjesë në sistemin edukativo arsimor është i obliguar që duke reaguuar të parandalojë diskriminimin ose ndonjë formë tjetër të shkeljes të të drejtave dhe atë duke mos vonuar dhe në interesin më të mirë të nxënësit. Profesorët kanë përgjegjësi të madhe që në mënyrë të drejtë të vlerësojnë rëndësinë e rastit në të cilin u shfaq diskriminimi dhe ta zgjidhin në mënyrën më të shpejtë dhe më të mirë. Prandaj është e rëndësishme që profesorët të dinë normat ligjore dhe hapat që duhet ndërmarr në mënyrë që të parandalohet krijimi i pasojave më të rënda të diskriminimit.

Për të parandaluar diskriminimin, arsimtarët duhet të kenë kujdes edhe që procesin e planifikimit dhe programimit në arsim ta përshtatin me nevojat e çdo nxënësi dhe hollësisht të njoftohen me nevojat e nxënësve, të dinë dhe të përcjellin karakteristikat e tyre zhvillimore dhe përparimin dhe në bazë të tyre të planifikojnë dhe hartojnë programin i cili do të ndjek nevojat dhe mundësitë mësimore të nxënësit. Ato duhet të kenë kujdes për kontekstin social prej të cilit nxënësit vijnë dhe të përpilojnë planet dhe programet të cilët në mënyrë të barabartë do të kyçin dhe angazhojnë të gjithë nxënësit, të nxisin punën e tyre të përbashkët dhe në skuadër me të cilën plotësojnë njëri tjetrin. Profesorët kanë detyrë të njoftohen dhe në mënyrë konsekuente të zbatojnë frymën e ligjit, të konventave dhe të dokumenteve të tjera të rëndësishme të cilët promovojnë të drejtat dhe liritë e nxënësit, të fëmijëve dhe të rinjve. Përfundimisht, ato, si modele prej të cilëve nxënësit mësojnë, duhet të kultivojnë me kolegët e tyre, administratën dhe aktorët e jashtëm komunikim të hapur, duke respektuar komunikimin dhe respektimin parimor të ndërsjellët në pajtim me të drejtat dhe



obligimet të cilat i përcaktojnë ligjet arsimore.

Për të parandaluar diskriminimin ndaj nxënësve nga grupet e caktuara shoqërore, siç janë Romët, profesorët duhet të përpiqen që gjatë procesit arsimor nxënësve t'i qasen me ndjesinë e nevojshme për karakteristikat e tyre individuale mësimore. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm në fazën e planifikimit dhe programimit, por edhe gjatë vlerësimit të arritjeve të nxënësit i cili duhet të njohë përparimin individual në mësimin e lëndës.

Roli parandalues i arsimtarit kërkon përpjekjen e tyre të vazhdueshme që aktivisht të kontribuojnë në zhvillimin e parimeve të mundësive të barabarta në institucionin arsimor, në punën me nxënës, gjegjësisht me kolegët. Arsimtarët e parandalojnë diskriminimin duke respektuar çdo fëmijë, përveç përcjelljes së dijes, ofrojnë përkrahje në zhvillimin e karakteristikave individuale dhe vlerave dhe aftësive sociale të të rinjve në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe pranimit të diferencave. Profesorët kanë rolin e pazëvendësueshëm në procesin e informimit dhe përkrahjes së nxënësve që të njohohen dhe aktivisht të shfrytëzojnë mundësitë e mbrojtjes nga diskriminimi, shkelja e të drejtave të njeriut dhe dhuna.

Drejtori i shkollës siguron barazinë e nxënësve në gëzimin e të drejtës për arsim dhe edukim, në pajtim me aftësitë e tyre. Në institucionin të cilin e drejton, drejtori ka rolin e pazëvendësueshëm në promovimin dhe avokimin e vlerave antidiskriminuese dhe respektimit të të drejtave të çdo nxënësi dhe të punësuarit. Ndjeshmëria e veçantë është e rëndësishme gjatë zbatimit të procedurave të regjistrimit në shkollë, që nënkupton kriteret e qartë të cilët njohin dhe kontribuojnë në realizimin e parimit të aksionit afirmativ, për shembull për nxënësit Romë. Drejtorja e shkollës duhet të ndër marrë të gjithë masat në mënyrë që institucioni arsimor të jetë përfshirës në kuptimin e plotë të fjalës.

Dikur rastet e diskriminimit janë të vështira dhe, përveç bisedës, kërkojnë edhe ndërmarrjen e masave disiplinore dhe edukuese, madje edhe iniciativën e drejtorit që rastet t'i zgjidh para institucioneve të tjera të cilët janë jashtë institucionit shkollor dhe pjesë të kompetencave të veta kanë mbrojtjen nga shkelja e të drejtave të njeriut dhe diskriminimi.

Detyra e shërbimeve profesionale (shërbimit pedagogjik - psikologjik) është që përmes përkrahjes profesionale të avancojnë punën edukativo – arsimore në institucionin arsimor dhe të ofrojnë ndihmë nxënësve, prindërve, stafit arsimor dhe administratës së shkollës lidhur me të gjithë çështjet me rëndësi për arsim dhe edukim.

Pedagogu i shkollës duhet të nxisë, krijoj, bashkëpunojë, vlerësoi, ofrojë ndihmë dhe përkrahje, të diagnostikojë, këshillojë, mësojë, organizojë, planifikojë dhe ndërmjetësojë në situatat problematike, gjegjësisht të kryejë aktivitetet të cilët mund të përcaktohen si parandaluese, këshilluese, udhëzuese, analitike, hulumtuese dhe operative.

Roli i pedagogut dhe psikologut të shkollës që të ofrojnë përkrahje dhe të kyçen ose



të ndërmjetësojnë në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit është i jashtëzakonshëm. Ato punojnë për sigurimin e të drejtës për çdo fëmijë që në mënyrë cilësore dhe të papenguar të mësojë dhe për mbrojtjen e tyre nga çdo formë e dhunës, keqpërdorimit dhe mbrojtjes së dinjitetit i cili në rastet e diskriminimit zakonisht dëmtohet seriozisht. Shërbimi psikologjik – pedagogjik ofron përkrahje dhe intervenon në situatat kritike në shkollë, atëherë kur ndodh rasti i diskriminimit ose dhunës në mes nxënësve të procesit edukativo – arsimor. Që të shmanget nevoja për intervenim të tillë, pedagogët dhe psikologët kanë rol të punojnë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve parandaluese kundër shfaqjes së diskriminimit ose të çdo shkelje tjetër të së drejtës, gjegjësisht dhunës. Kontaktimi i psikologut ose pedagogut është konfidencial, sepse është shumë e rëndësishme që të rinjtë të kenë lirinë që problemin e tyre, ose ndonjë situatë, ta ndajnë me shërbimin që në mënyrën më të mirë t'i ndihmojë, si dhe të dinë se nuk janë vet në situatën kur janë të ekspozuar ndaj pasojave të diskriminimit ose dhunës. Konfidencialiteti është një nga parimet bazë të këtyre shërbimeve dhe pasqyrohet në obligimin që të gjithë të dhënat, informatat të cilat i marrin lidhur me fëmijët dhe nga fëmijët të trajtohen në pajtim me mbrojtjen e privatësisë dhe personalitetit të fëmijës deri në momentin kur ta kenë pëlqimin e prindit dhe nxënësit që t'i shfrytëzojnë dhe t'i bëjnë publike, nëse për këtë gjë shfaqet nevoja dhe në pajtim me ligjin. Në shkollat të cilat kanë shërbimin pedagogjik dhe psikologjik, ai është resurs i vlefshëm në formimin e kulturës antidiskriminuese.

Shërbimet pedagogjike dhe psikologjike kanë rëndësi veçanërisht të rëndësishme në zhvillimin e programeve të parandalimit të diskriminimit dhe të dhunës në shkolla dhe përfshijnë dhunuesit dhe viktimat, sepse kjo është marrëdhënie e dy palëve në të njëjtin rrafsh. Përmes programeve edukative duhet forcuar dhe zhvilluar kompetencën sociale të njërës dhe të tjetrës anë.

Kusht i reagimit/intervenimit në kohë dhe adekuat në rastin e diskriminimit është përcjellja e vazhdueshme e situatës në institucionin shkollor, bisedat e shpeshta me nxënësit, vëmendja konstante e cila siguron që në kohë të identifikohen veprimet të cilët në qasjen në arsim, përmbajtjes së tij, marrëdhënieve në mes aktorëve të procesit edukativo – arsimor mund të iniciojnë apo tregojnë për shfaqjen e diskriminimit.

Në rastin e diskriminimit është me rëndësi që menjëherë të ndalohej sjellja/të vepruarit diskriminues. Është e nevojshme që të përkrahen palët e rastit, si viktimës, ashtu edhe diskriminuesit dhe dëshmitarëve të ngjarjes. Me viktimën e diskriminimit duhet biseduar dhe t'i tregohet se kanë përkrahjen, që mos të kenë frikë, që nuk është vet, që nuk është fajtor për diskriminimin e përjetuar, që është viktimë e sjelljes së gabuar dhe të palejuar, e cila është e dënueshme dhe e cila do të sanksionohet. Po ashtu, është me rëndësi që të ti jepet kurajë viktimës që të bashkëpunojë dhe të komunikojë hapur, në mënyrë që të vërtetohen faktet për rastin dhe të kontribuohet në zgjidhjen e tij të shpejt dhe të suksesshëm. Kjo ndonjëherë kërkon kohë, qasje të kujdeshme ndaj viktimës, durim gjatë bisedës, në veçanti me personin e ri i cili nuk e ka të lehtë



të bisedojë për eksperiencën e diskriminimit, dhunës ose për ndonjë shkelje tjetër të të drejtave të njeriut. Eksperienca e diskriminimit është e rëndë dhe kërkon përkrahje të fuqishme. Në bisedë me viktimën dhe diskriminuesin është e nevojshme që të kyçet edhe dikush nga aktorët e procesit edukativo – arsimor, siç janë shërbimet profesionale si përkrahje në këto situata të ndjeshme për të dy palët, në veçanti nëse bëhet fjalë për të rinj, nxënës. Është e nevojshme që menjëherë të njoftohen prindërit e nxënësit dhe me ato të bisedohet, të informohen për detajet dhe të kyçen në zgjidhjen e problemit, së bashku me bashkëpunimin dhe këshillimin me shërbimet profesionale në shkollë. Gjatë procedimit të rastit, duhet shënuar të gjitha hollësitë në formën e shënimit zyrtar i cili më vonë shërben si bazë për ndërmarrjen e masave konkrete dhe zgjidhjen e rastit brenda shkollës, ose jashtë sistemit tek institucionet kompetente. Pasqyrimi sa më i hollësishëm i informatave dhe i përshkrimit të situata janë të rëndësishëm për zgjedhjen e drejtë të strategjisë për zgjidhjen e rastit. Gjatë bisedës me viktimën e diskriminimit, por edhe me diskriminuesin, duhet kushtuar vëmendja në faktorët familjar, karakteristikat e kornizës familjare nga i cili të rinjtë vijnë, a është dikush prej tyre edhe në familjen e vet viktimë e dhunës dhe injorimit, etj. Të gjitha këto informata janë të rëndësishme për formimin e imazhit të plotë dhe mund të tregojnë rrugën drejtë të vepruarit e efektiv. Diskriminimi nganjëherë kalon në dhunë fizike, ose dhunë të rëndë verbale e cila pastaj zgjidhet me zbatimin e masave edukuese, gjegjësisht disiplinore. Në rastet e diskriminimit serioz dhe të rëndë, gjegjësisht dhunës së rëndë fizike, është e nevojshme të kyçet edhe policia, e në rastet kur janë të përfshirë të rinjtë edhe Qendra për Punë Sociale. Çfarë do incidenti të ndodh të vepruarit duhet të jetë me respekt të plotë ndaj personalitetit të viktimës dhe të diskriminuesit, të shqyrtojë me kujdes të gjithë aspektet e rastit, në mënyrë që procedimi të zhvillohet në mënyrë adekuate dhe të ketë efekt në interesin më të mirë të të dy palëve.



Sistemi i përkrahjes së jashtme në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit në arsim

Problemet dhe rastet e diskriminimit dhe të shkeljes së të drejtave të njeriut në shkollë më së miri është të zgjidhen brenda institucionit, përmes rrjetit të përkrahjes të cilin e përbëjnë profesorët, kujdestari i klasës, drejtori gjegjësisht administrata e shkollës, si dhe përmes ndihmës së shërbimeve profesionale dhe duke bashkëpunuar me këshillin e prindërve dhe të nxënësve. Nëse rasti është më i kompleks, ose viktima e diskriminimit dhe e shkeljes të të drejtave të njeriut nuk është e kënaqur si shkolla e zgjidhi situatën, atëherë mund t'i drejtohet edhe institucioneve të cilët veprojnë jashtë institucionit shkollor, e të cilët janë kompetent që të kontrollojnë punën e shkollës në pajtim me ligjin, siç është Ministria e Arsimit, Departamenti për Inspektoratin në Arsim dhe Sport (Inspektorati i dikurshëm arsimor), Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe në gjykatë.

Departamenti i Inspektoratit për Arsim dhe Sport

Departamenti i Inspektoratit për Arsim dhe Sport, në pajtim me kompetencat e tija, mund të kontribuojë në zgjidhjen e rasteve të diskriminimit në arsim, meqë kjo që përbënë shkelje të rëndë të parimeve dhe dispozitave të të gjithë ligjeve arsimore në zbatimin e të cilëve Departamenti bënë kontrollin.

Kontrolli inspektues është i rregullt, të paktën një herë në vit, por mund të jetë edhe i jashtëzakonshëm (sipas njoftimit), si dhe kontrollues i cili bëhet për të vërtetuar se a veprohet sipas vendimit të kontrollit inspektues i cili ka identifikuar ndonjë kundërvajtje ose shkelje të rëndë të ligjit.

Inspektorati udhëhiqet nga parimi i parandalimit dhe urgjencës, dhe gjatë kontrollit inspektues përpilohet procesverbali dhe miratohet përfundimi, gjegjësisht vendimi, me të cilin urdhërohet shkolla që të përmirësojë parregullsinë në afatin e caktuar. Nëse të vepruarit parandalues nuk kishte efekt atëherë ndërmerren masat më të rrepta.

Mbrojtësi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Në rastin e diskriminimit në lëminë e arsimit ekziston mundësia e adresimit të Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, gjegjësisht Ombudspersonit, si

mekanizëm institucional për mbrojtjen nga diskriminimi. Formulari për ankesa është në ueb faqen e institucionit, por mund të dërgohet edhe shkresa e cila duhet të përbëjë informatat e sakta duke përfshirë këtu edhe bazën për diskriminim. Procesi tek Ombudspersoni është falas dhe konfidencial.

Pasi që të hetohet rasti konkret, Ombudspersoni përcakton se a janë shkel të drejtat e njeriut apo a ngjau diskriminimi. Nëse përcakton se kishte shkelje, ose ngjau diskriminimi, ai ia dërgon mendimin e vet institucionit arsimor ku ndodhi rasti me rekomandim dhe afat deri kur shkelja duhet të eliminohet. Nëse institucioni arsimor nuk vepron sipas rekomandimit të Ombudspersonit, ai mund të thërras edhe organin më të lartë (për shembull Ministrinë e Arsimit) që të njoftohet me rastin dhe të kontribuojë që të zbatohet, ose mund të njoftojë opinionin përmes raportit ose mediave në mënyrë që të bëjë presion që rasti të zgjidhet. Në varësi nga rëndësia e rastit të diskriminimit institucioneve mund ta udhëzojë palën që të procedojë rastin para gjykatës.

Mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi

Neni 15 i Ligjit për Parandalimin e Diskriminimit thekson se: *"Diskriminimi në arsim dhe edukim, gjegjësisht në aftësimin profesional është vështirësimi ose pamundësimi i regjistrimit në institucionin edukativo – arsimor dhe institucionin e arsimit të lartë dhe përzgjedhjes së programit në të gjithë nivelet e arsimit dhe edukimit, përjashtimi nga këto institucioni në kundërshtim me dispozitat nga fusha e arsimit dhe edukimit, vështirësimi ose pamundësimi i përcjelljes së mësimin në kundërshtim me dispozitat nga fusha e arsimit dhe edukimit, vështirësimi ose pamundësimi i ndjekjes së mësimin dhe i pjesëmarrjes në aktivitetet tjera edukativo – arsimore, dallimi i fëmijëve, nxënësve/eve dhe studentëve/eve ose diferencimi në mënyrë tjetër apo të vepruarit e pabarabartë ndaj tyre, sipas ndonjëres nga bazat nga neni 2 paragrafi 2 i këtij Ligji"*²³.

Në rastin e diskriminimit çdo kush ka të drejtë të dorëzojë padinë në gjykatë me qëllim mbrojtjen e të drejtave. Kontestet gjyqësore kundër diskriminimit karakterizohen për nga, i ashtuquajturit, *komulimi i përgjithshëm i kërkesave paditëse*. Kjo do të thotë se me kërkesën paditëse mund të kërkohet përcaktimi i diskriminimit, ndalimi i kryerjes ose përsëritjes së diskriminimit, eliminimi i pasojave të diskriminimit, kompensimi i dëmit dhe kërkesa për publikimin e aktgjykimit për diskriminim. Vet vërtetimi i ekzistencës së diskriminimit nuk ofron shkallën e përshtatshme të mbrojtjes nga kjo lloj i të vepruarit, prandaj vetëm me kumulimin e disa nga kërkesat e cekura ky mekanizëm arrijnë objektivin e plotë mbrojtës.



Dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare që përcaktojnë ndalimin e diskriminimit

Ndalimi i diskriminimit - korniza juridike malazeze
Kushtetuta e Malit të Zi - themeli i ndalimit të diskriminimit

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe ndalimi i diskriminimit janë kategori kushtetuese

Kushtetuta e Malit të Zi garanton mbrojtjen e pacënueshmërisë dhe ia përcakton qytetarëve obligimin e respektit të ndërsjellët të të drejtave dhe lirive njerëzore, si dhe barazinë e të gjithëve para ligjit pavarësisht nga vetitë apo karakteristikat individuale. Kushtetuta e ndalon nxitjen e urrejtjes dhe jotolerancës ndaj kujtdo, mbi çfardo lloj baze, si dhe diskriminimin. Diskriminimi lejohet vetëm në rastet e aplikimit të rregullave dhe masave të veçanta të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë të personave të cilët gjenden në pozicionin e jobarabartë, siç është nxitja e barazisë gjinore apo kombëtare. Vendosja e masave të nevojshme është e justifikueshme vetëm deri sa të realizohen qëllimet për të cilat ato janë vendosur. Kushtetuta e garanton të drejtën për shkollimin në kushte të barabarta dhe përcakton që edukimi fillestar është obligativ dhe falas. Sa i përket pjesës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Kushtetuta përcakton një sërë të drejtash, siç janë e drejta për paraqitjen e lirë të identitetit, veçorive etnike dhe fetare, përdorimin privat dhe zyrtar të alfabetit, shfaqjen e simboleve kombëtare dhe celebrimin e festave. Në fushën e arsimit, pakicat kanë të drejtën e edukimit në gjuhën dhe alfabetin amëtar në institucionet shtetërore përmes programeve të cilat përfshijnë historinë dhe kulturën e pakicave.

Ligji i punës - ndalimi i diskriminimit në punësim dhe në bazë të punës

Rregullat e këtij ligji janë posaçërisht të rëndësishme për të gjithë të punësuarit në procesin edukativ -arsimor dhe paraqesin bazë për njohjen dhe procedimin e rasteve të diskriminimit i cili ndodh në procesin e punësimit apo në punë.

Ndalimi i diskriminimit është i përfshirë në dispozitat e Ligjit për Punë, në të cilin ndalohet diskriminimi direkt dhe indirekt gjatë kërkimit të punës, si dhe në realizimin e të drejtave të të punësuarve sipas bazave të shumta të ndaluara. Me ligj parashikohet ndalimi në fushën e përcaktimit të kushteve për punësimin, gjegjësisht gjatë konceptimit të konkursit, përzgjedhjes së kandidatëve për pozicione pune të caktuara, sigurimit të kushteve të punës dhe pranë sigurimit të të drejtës së punësimit, fushës së arsimit dhe përgatitjes profesionale, në procedura dhe rregulla për avancim në punë ose gjatë vendosjes për përjashtim nga puna dhe dorëzimit të vendimit për përjashtim nga puna.



Ligji i Punës ndalon shqetësimin dhe ngacmimin seksual në punë dhe në lidhje me punë, si dhe viktimizimin e atyre të cilët vendosin ta procedojnë diskriminimin.

Ligji e definojnë dhe mobingun si një lloj të keqtrajtimit në punë, përkatësisht *"çdo sjellje ndaj të punësuarve apo grupit të të punësuarve tek punëdhënësi e cila përsëritet, dhe ka për qëllim apo duket si lëndim i dinjitetit, reputacionit, integritetit personal dhe profesional, statusit të të punësuarit, e cila shkakton frikë apo krijon mjedis armiqësor, përlulës apo ofendues, përkeqëson kushtet e punës ose sjell deri tek izolimi i të punësuarit ose dhënien e dorëheqjes në punë me vetë dëshirën e të punësuarit."*²⁴

Diskriminimi pozitiv, është gjithashtu i përcaktuar me ligj, si dhe masat e veçanta për mbrojtjen e kategorive të caktuara të cilat janë të përcaktuara me ligj, kontratë kolektive dhe kontratën e punës, të cilët kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave me invaliditet, grave gjatë shtatzënisë dhe mungesës në lehonë, kujdesit dhe kujdesit të veçantë të fëmijës të cilët nuk konsiderohen si diskriminim.

Sipas shkronjave të Ligjit, arsimit dhe arsimit profesional duhet të jenë të disponueshëm për të gjithë pa diskriminim dhe të sigurohet gjithmonë kur ajo është kërkesë e vendit të punës.

Ligji për Barazinë Gjinore - ndalimi i diskriminimit me bazë gjinore dhe identitetit gjinor

Ligji për Barazinë Gjinore rregullon mënyrën me të cilën sigurohet dhe zhvillohet koncepti i realizimit të barazisë gjinore, si dhe masat për largimin e diskriminimit me bazë gjinore me qëllimin e krijimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe meshkujve dhe identiteteve të tjera gjinore në përputhje me standardet më të larta në të gjitha sferat e shoqërisë.

Barazia gjinore përkufizohet si *"pjesëmarrja e barabartë e grave dhe meshkujve, si dhe të personave me identitet gjinor të ndryshëm, në të gjitha zonat e sektorit publik dhe privat, pozitive të barabartë dhe mundësi të barabartë për realizimin e të të gjitha drejtave dhe lirive dhe përdorimi i dijeve dhe mundësive personale për zhvillimin e shoqërisë, si dhe realizimi i fitimit nga rezultatet e punës"*.²⁵

Ligji e definojnë diskriminimin mbi bazë gjinore si *"çdo bërje dallimi apo veprimi të pabarabartë juridik apo faktik, direkt apo indirekt, përkatësisht mosveprimi ndaj një individ, apo një grupi të individëve të një gjinie në krahasim me individët e gjinisë tjetër, si dhe përjashtimi, kufizimi apo dhënie përparësie një individ, apo grupit të individëve të një gjinie në krahasim me gjininë tjetër, për shkak të së cilës individit të caktuar i vështirësohet apo mohohet pranimi, përdorimi apo realizimi i të drejtave dhe lirive"*

²⁴ Ligji i Punës, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 049/08, 026/09, 088/08, 026/10, 059/11, 066/12, 031/14, 053/14, 004/18

²⁵ Ligji për Barazinë Gjinore, Fletorja Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 46/07, dhe Fletorja Zyrtare e Malit të Zi nr. 73/10, 40/11, 35/15.



njerëzore në jetën qytetare dhe politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në sfera tjera të jetës publike dhe private".²⁶

Ligji definoi si trajtim të pabarabartë çdo veprim me anë të së cilit bëhet dallimi ndërmjet meshkujve dhe femrave për shkak se ato i përkasin gjinive të ndryshme, apo i jepet përparësia pa justifikim individit të një gjinie në krahasim me individin e gjinisë tjetër. Institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera në të gjitha sferat e shoqërisë gjatë sjelljes së vendimeve, kryerjes së aktiviteteve nga kompetencat e tyre, bëjnë kujdes dhe e vlerësojnë ndikimin në arritjen e barazisë gjinore.

Në përputhje me ligjin, çdo nxitje, ndihmë, dhënie instruksionesh që një individ apo grup të diskriminohet mbi baza gjinore definohet si diskriminim.

Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave - ndalimi i diskriminimit mbi bazë kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore.

Sipas ligjit, pakicat janë të barabarta me shtetasit e tjerë dhe kanë mbrojtje të njëjtë, dhe çdo shkelje e të drejtave të pakicave është jashtëligjore dhe e dënueshme. Pakicat kanë të drejtë të shprehen, ruajnë, trashëgojnë dhe zhvillojnë identitetin dhe traditën e tyre. Shteti i Malit të Zi ka obligim ligjor të zhvillojë dhe avancojë studimin e traditës, kulturës dhe gjuhëve të pakicave. Ligji i garanton pakicave të drejtën për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit. Në ato mjedise ku pakicat përbëjnë shumicën apo së paku 5% të popullsisë, sipas dy regjistrimeve të fundit, gjuha e pakicave është në përdorim zyrtar. Kjo do të thotë që emrat e shkollave shkruhen edhe në gjuhën e pakicave. Ligji i garanton pakicave të drejtën e arsimimit në gjuhën e tyre si dhe përfaqësimin adekuat të gjuhës në arsimin e përgjithshëm dhe profesional, në varësi të numrit të nxënësve dhe mundësive financiare të shtetit. Programet e lëndëve për edukimin e pakicave përmbajnë edhe pjesët për historinë, kulturën dhe traditën e pakicave.

Në shkollat në të cilat zhvillohet arsimi në gjuhën zyrtare, ligji parashikon që programet e lëndëve të përfshijnë përmbajtjen e cila i referohet historisë, kulturës dhe traditës të pakicave në mënyrë që përmes procesit arsimor të inkurajohet mirëkuptimi dhe toleranca reciproke. Pakicat janë të përfshira edhe në hartimin e programeve për shkollat në gjuhën e pakicave dhe gjuhën zyrtare përmes mendimit që Këshilli i Pakicave ia jep institucionit përkatës. Ligji parashikon që arsimin në gjuhën e pakicave ta bëjnë arsimtarët të cilët i përkasin pakicave, apo përfaqësuesit e popullatës shumicë të cilët kanë dijeni aktive të gjuhës së pakicave. Drejtorët e institucioneve arsimore të cilët edukojnë në gjuhët e pakicave po ashtu i përkasin pakicave. Gjatë përzgjedhjes së drejtorit, institucionit i cili e bënë këtë përzgjedhje për drejtorin e shkollës, i jepet mendimi nga ana e Këshillit të Pakicave Kombëtare.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit të Personave me Invaliditet

Ligji parashikon qartazi ndalimin e diskriminimit të individëve apo grupit të individëve me invaliditet në të gjitha sferat, si dhe mbrojtjen dhe masat për promovimin e barazisë së këtij grupi. Në pjesën që i referohet ndalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi aplikohen vendimet e Ligjit për Ndalimin e Diskriminimit dhe të ligjeve të tjera të cilët e ndalojnë diskriminim në fusha të ndryshme në qoftë se nuk janë në kundërshtim me ligjin bazë.

Diskriminimi mbi bazën e invaliditetit është definuar si *"çdo bërje dallimi apo veprimi të pabarabartë juridik apo faktik, direkt apo indirekt, qëllimshëm apo jo qëllimshëm, përkatësisht shmangia e veprimit ndaj një individi, apo një grupi individësh me invaliditet në krahasim me personat e tjerë, si dhe përjashtimi, kufizimi apo dhënia e përparësisë të një individi në krahasim me individin me invaliditet, për shkak të cilit individit me invaliditet i vështirësohet apo mohohet pranimi, përdorimi apo realizimi i të drejtave dhe lirive njerëzore në sferën politike, arsimore, ekonomike, sociale, kulturore, sportive, qytetare të jetës publike dhe private".*
27

Është e ndaluar çdo veprimtari e cila nxit apo instruktton diskriminim, apo shqetëson individin me invaliditet. Ligji nuk i liron nga përgjegjësia individët të cilët e bëjnë diskriminim as në rastin e pranimit të personit me invaliditet që të diskriminohet. Si forma të veçanta të diskriminimit, ligji i njeh gjuhën e urrejtjes dhe nënvlerësimit, si dhe segregacionin apo grupimin e individëve në bazë të invaliditetit.

Grupimi apo segregacioni është formë e veçantë e diskriminimit e cila manifestohet kur grupimi është i planifikuar, sistematik ose veçimi në vazhdimësi i individëve apo grupeve të individëve me invaliditet dhe bashkimi i tyre në një apo më shumë grupe në situatën e caktuar, kur në situatë të njëjtë apo të ngjashme veçimi dhe bashkimi nuk i bëhet individit apo grupit të individëve të tjerë. Kjo dukuri është posaçërisht e rrezikshme në fushën e arsimit dhe është në kundërshtim të plotë me qëllimet dhe shpirtin e ligjeve të arsimit.

Diskriminim quhet dhe pa disponueshmëria e objekteve dhe sipërfaqeve në përdorimin publik, mungesa e qasjes së siguruar, lëvizjes, banimit dhe punës në objektet në përdorim publik, si dhe qasja në sipërfaqet publike në përputhshmëri me përcaktimet për rregullimin e hapësirës dhe ndërtimit të objekteve.

Është i ndaluar diskriminimi në fushën e arsimit, edukimit dhe aftësisht profesional të personave me invaliditet, tek: *"1) pamundësimi, kufizimi apo vështirësimi i personit me invaliditet gjatë zgjedhjes së programit arsimor dhe regjistrimit, qasjes dhe qëndrimit në institucionin edukativ-arsimor, në përputhje me mundësitë e tija; 2) pamundësimi, kufizimi apo vështirësimi i personit me invaliditet në ndjekjen e mësimin dhe kontrollit të dijes, si dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e tjera arsimore, apo edukative, duke përfshirë dhe aktivitetet jashtëshkollore*



dhe garat; 3) mosndërmarrja dhe mos aplikimi i masave të veçanta nga neni 5 i këtij ligji për vendosjen dhe dhënien e përkrahjes të personalizuar për ndjekjen e mësimdhënies pa pengesa dhe kontrollit të dijes, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete tjera edukative, apo arsimore, duke përfshirë dhe pjesëmarrjen në aktivitetet jashtëshkollore dhe garat, në përputhje me përcaktimet nga fusha arsimore dhe edukative; dhe 4) përjashtimi i individit me invaliditet nga institucioni edukativo-arsimor kur në situatë të njëjtë apo të ngjashme këtij veprimi nuk i nënshtrohen bashkëmoshatarët e tij".²⁸

Kodi Penal i Malit të Zi

Kodi Penal përcakton si vepër penale diskriminim racor me të cilën dënohet shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe rregullat juridike ndërkombëtare sipas ndryshimit racorë apo ndonjë karakteristike tjetër individuale.

Gjatë përcaktimit të dënimit për veprën penale të bërë nga urrejtja është paraparë rrethana e vështirësuar të cilin gjykata do ta vlerësojë nëse është vepër penale e bërë nga urrejtja racore, fetare, kombëtare ose e përkatësisë etnike, gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor të individit të caktuar.

Për mbrojtjen nga diskriminimi në arsim është i rëndësishëm edhe Neni 433 i Kodit Penal *Diskriminimi racor dhe tjetër* "(1) Kush për shkak të përkatësisë kombëtare ose etnike, përkatësisë racore apo fetare apo të mungesës së përkatësisë, ose për shkak të diferencave në aspektin politik apo të ndonjë bindjeje tjetër, gjinisë, gjuhës, edukimit, statusit shoqëror, statusit social, orientimit seksual, identitetit gjinor, invaliditetit, gjendjes materiale apo ndonjë karakteristike tjetër individuale, shkel të drejtat dhe liritë njerëzore themelore të garantuara me rregullat e gjithë pranuar të të drejtës ndërkombëtare dhe të kontratave të konfirmuara ndërkombëtare nga ana e Malit të Zi, do të dënohet me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vite, (3) Kush përhap idetë për superioritetin e një race ndaj tjetrës ose propagandon urrejtjen ose jo tolerancën racore, gjinore, të invaliditetit, orientimit seksual, identitetit gjinor ose të ndonjë karakteristike tjetër individuale ose nxit diskriminimin racor apo ndonjë tjetër, do dënohet me burg nga tre muaj deri në tre vite".²⁹

Me Kodin Penal është e parashikuar edhe vepra penale shkelja e barazisë "Kush për shkak të përkatësisë etnike, përkatësisë racore ose fetare ose mungesës të përkatësisë ose për shkak të këndvështrimeve politike të ndryshme ose ndonjë bindjeje tjetër, gjinisë, gjuhës, statusit shoqëror, statusit social, orientimit seksual, identitetit gjinor, invaliditetit, gjendjes materiale ose ndonjë karakteristike tjetër personale, ja ndërpret ose kufizon tjetrit të drejtat dhe liritë njerëzore të përcaktuara me Kushtetutë, ligje ose rregulla të tjera ose akte të përgjithshme ose të konfirmuara me marrëveshje ndërkombëtare ose në bazë të dallimit i jepen privilegje ose përparësi, do dënohet me burg deri në tre vite".³⁰

28 Njëjtë

29 Njëjtë

30 Njëjtë

Parimet antidiskriminuese dhe vlerat në ligjet kombëtare të cilat e rregullojnë fushën e arsimit

Sipas Ligjit të përgjithshëm mbi Arsimin dhe Edukimin, qëllimi i arsimit është që të "sigurojë mundësitë për zhvillimin e gjithanshëm të individit, pavarësisht gjinisë, moshës, invaliditetit, prejardhjes sociale dhe kulturore, përkatësisë kombëtare dhe fetare dhe konstitucionit fizik dhe mendor".³¹ Po ashtu, qëllimi i edukimit dhe arsimit është "të zhvillojë vetëdijen, nevojën dhe mundësinë për ruajtjen dhe avancimin e të drejtave njerëzore, shtetit ligjor, mjedisit natyror dhe shoqëror, multietnicitetit dhe diferencës".³² Në procesin e edukimit dhe arsimit çdokush ka të drejtë për pjesëmarrje të barabartë dhe participim.

Ligji e definon edukimin si veprimtari me interes publik, dhe në këtë kuptim arsimit është botëror, çfarëdo thotë që në institucionet shkollore, përkatësisht në institucionet publike nuk lejohet veprimtaria fetare, përveç në shkolla që janë të licencuara si shkolla fetare. Është e rëndësishme dispozita e Ligjit e cila flet për autonominë e institucioneve të edukimit në të cilët nuk lejohet veprimtaria dhe organizimi politik, si dhe organizimi i evenimenteve politike.

Ligji parashikon që renditja e institucioneve arsimore në terren duhet të sigurojë disponueshmërinë e arsimit dhe edukimit për të gjithë qytetarët. Shtetasit e Malit të Zi janë "të barabartë në realizimin e të drejtave në edukim, pavarësisht përkatësisë kombëtare, racës, gjinisë, gjuhës, fesë, prejardhjes sociale, invaliditetit apo të ndonjë karakteristikë tjetër individuale. Shtetasit e huaj të cilët janë përkohësisht ose për kohë të gjatë banues të Malit të Zi, janë të barabartë në realizimin e të drejtës për arsim me shtetasit malazez, në përputhshmëri me ligjin e veçantë".³³ Rreptësisht ndalohet diskriminimi: "Në institucion nuk lejohet: dhuna fizike, psikike apo sociale; keqtrajtimi dhe injorimi i fëmijëve dhe nxënësve; dënimi fizik dhe ofendimi i personalitetit, si dhe keqpërdorimi seksual i fëmijëve dhe nxënësve apo të punësuarve dhe çdo lloj diskriminimi tjetër në përputhje me ligjin".³⁴

Në tekstin ligjor përcaktohen të drejtat dhe obligimet e të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor-edukativ, procedurat e formimit dhe kompetencat të trupave profesionale në shkollë (këshillit të arsimtarëve), këshillit të prindërve, parlamentit të nxënësve, nxënësve, dhe arsimtarëve në përgjithësi. Ligji e thekson të drejtën e nxënësve për mbrojtjen nga të gjitha llojet e dhunës në shkollë, diskriminimi, keqtrajtimi dhe injorimi.

Dispozitat antidiskriminuese në Ligjin e përgjithshëm për Arsim, si dhe standardet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare kundër diskriminimit përmbledhin zgjidhjet ligjore të cilat rregullojnë në veçanti çdo nivel arsimor, nga ai fillor, i mesëm, deri tek i arsimit të lartë.

31 Ligji i përgjithshëm për Arsim dhe Edukim, Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, nr. 64/2002, 31/2005, 49/2007, 4/2008 – Ligji tjetër, 21/2009 – Ligji tjetër, 45/2010, 40/2011 – Ligji tjetër, 45/2011, 36/2013 – Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, 39/2013 dhe 44/2013 dhe 47/2017. Shih: Vendimi i GJK MZ – 12/2011. Shih: Vendimi i GJK MZ 23/2011.

32 Njëjtë

33 Njëjtë

34 Njëjtë



Ndalimi i diskriminimit dhe e drejta për arsim - standardet ndërkombëtare Deklarata universale për të drejtat e njeriut

Përveç promocionit të parimit universal për ndalimin e diskriminimit, Deklarata thekson rëndësinë kyçe të arsimit dhe edukimit në realizimin e standardeve të të drejtave të njeriut të cilat deklarata i përmban dhe i promovon.

Në nenin 7 Deklarata promovon ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit: *"Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe pa dallim kanë të drejtën e barabartë për mbrojtjen ligjore. Të gjithë e kanë të drejtën për mbrojtjen e barabartë kundër çdo lloj diskriminimi i cili shkel ketë Deklaratë dhe kundër çdo nxitjeje të këtij lloji të diskriminimit".*³⁵

Në nenin 26 parashihet që *"1. Çdo njeri ka të drejtë të arsimohet. Arsimi duhet të jetë falas të paktën në shkollat fillore dhe shkollat e ulëta. Arsimi fillor është obligator. Arsimi teknik dhe profesional duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë në bazë të aftësisë së tyre. Arsimi duhet të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe fuqizimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të avancojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë ndërmjet të gjithë popujve, grupeve racare dhe fetare, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për mirëmbajtjen e paqes".*³⁶

Konventa e të drejtave të personave me invaliditet³⁷

Konventa obligon shtetet nënshkruese që të sigurojnë edukimin inkluziv në të gjitha nivelit si dhe mësimin përgjatë gjithë jetës i cili bazohet në parimet e mundësive të barabarta dhe pa diskriminim. Obligimi i shteteve nënshkruese është ndërtimi i sistemit të edukimit i cili do të mundësojë zhvillimin e potencialit të njerëzve me invaliditet, forcimin e ndjenjës së tyre për dinjitet dhe vlera duke respektuar të drejtat, liritë dhe ndryshimet njerëzore. Konventa obligon krijimin e sistemit të edukimit i cili zhvillon talentet, kreativitetin në potencialin e plotë fizik dhe mendor, në mënyrë që të aftësojë individët me invaliditet që të marrin pjesë në jetën e shoqërisë.

Nënshkruesit e Konventës garantojnë që do të punojnë në ndalimin e përjashtimeve të fëmijëve me invaliditet nga edukimi fillor dhe i mesëm obligator, gjegjësisht do i përfshijnë ato në arsim mbi baza të barabarta me të tjerët. Nënshkruesit janë të obliguar t'i sigurojnë personave me invaliditet qasjen pa pengesa në arsim të mesëm, aftësimin profesional, arsimin e të rriturve dhe edukimit gjatë gjithë jetës pa diskriminim dhe të barabartë me të tjerët me përshtatje racionale e cila duhet të mundësojë qasjen më të lehtë dhe përdorimin e objekteve të institucioneve arsimore.

35 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e miratuar dhe e shpallur me Rezolutën e Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara 217 (III) me 10 dhjetor të vitit 1948.

36 Njëjtë

37 Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njerëzve me Invaliditet me Protokollin Opsional. Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, me 13 dhjetor të vitit 2006.



Kjo përfshinë përshtatjen racionale të arsimit për individët me invaliditet dhe mundësimin e përkrahjes në procesin arsimor që të kontribuoj suksesit arsimor si parakusht për përfshirjen në shoqëri, p.sh. mësimi i Alfabetit të Brajit, mënyrave dhe mjeteve alternative të komunikimit, aftësinë e orientimit dhe sistemeve të tjera të përkrahjes, si p.sh. punës së mentorit për lëvizjen e suksesshme dhe të pavarur, etj.

Përveç kësaj, shtetet nënshkruese do t'i kushtojnë vëmendje punësimit të kuadrove arsimore të cilët flasin gjuhën e shenjave dhe që e njohin Alfabetin e Brajit, posaçërisht t'i punësoj personat me invaliditet si arsimtarë, të punësojë ekspertët dhe stafin i cili do të jetë përkrahës në të gjitha nivelet e arsimit. Obligimi i shteteve nënshkruese është që t'ia sigurojë individëve me invaliditet qasjen pa pengesa në arsimin e mesëm, aftësimin profesional, në arsimin e të rriturve dhe arsimin gjatë gjithë jetës, pa diskriminim dhe barabartë me të tjerët me përshtatje racionale e cili duhet të sigurojë qasjen më të lehtë dhe përdorimin e objekteve të institucioneve edukative.

Konventa për të drejtat e fëmijëve³⁸

Kjo konventë është dokument kyç i cili ka për qëllim të garantojë respektimin e të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë dhe të drejtën për arsim, që arsimi fillor të jetë falas dhe i disponueshëm për të gjithë.

Konventa i përkrah shtetet anëtare të bëjnë gjithçka që arsimi i përgjithshëm dhe i mesëm të jenë të disponueshëm për të gjithë, por edhe pa pagesë.

Nënshkrueset obligohen të punojnë për uljen e përqindjes së lënies së shkollës, të sigurohet informimi i nxënësve për të gjithë aspektet e rëndësishme të arsimit. Ato bien dakord që arsimi synon zhvillimin e personalitetit, talentit dhe aftësive mendore, fizike deri në kapacitetin e tyre të plotë, si dhe në zhvillimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të parimeve të cilët i garanton Deklarata e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut të KB-së, zhvillimin, përmes arsimit, të respektit për identitetin e vet kulturor të individit, të gjuhës dhe vlerave, por edhe për kulturat dhe civilizimet e tjera.

Shtetet nënshkruese obligohen të krijojnë sistemin e arsimit i cili i përgatit fëmijët për pranimin e përgjegjësive në jetën shoqërore, zhvillimin e tolerancës dhe kuptimin e paqes, barazisë gjinore dhe miqësisë së popujve, etnive, grupeve kombëtare dhe fetare.

Gjithashtu, shtetet duhet të zhvillojnë masat të cilat do e ndalojnë pengimin e edukimit të fëmijëve siç është eksploatimi dhe puna e fëmijëve, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë që disiplina në shkollë të zhvillohet në mënyrën e cila i përshtatet dinjitetit njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me Konventën.

38 Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, 1989.



Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut

Sa i përket të drejtës për arsim, Konventa garanton që askujt nuk guxohet t'i mohohet e drejta për arsim. Gjatë kryerjes së funksionit të vet në arsim dhe mësimdhënie, shteti duhet të respektojë të drejtën e prindit që të sigurojë edukimin dhe arsimin i cili është në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike. Neni 14 përcakton: *"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara me këtë Konventë sigurohet pa diskriminim mbi çfarëdo lloj baze, siç janë gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, feja, mendimi politik apo tjetër, prejardhja kombëtare apo sociale, lidhshmëria me ndonjë minoritet kombëtar, gjendja materiale, lindja apo ndonjë status tjetër".*³⁹

Në Protokollin 12 bashkë me Konventën është përcaktuar edhe ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit në atë kuptim që, çdo e drejtë e cila parashikohet me ligj, duhet të realizohet pa diskriminim mbi çfarëdo lloj baze si p.sh. mbi bazën e gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, bindjes politike apo tjetër, origjinës kombëtare apo sociale, lidhjes me pakicat kombëtare, statusin material apo tjetër.

Konventa kornizë për Mbrojtjen e Pakicave⁴⁰

Konventa obligon palët e kontraktuara që t'iu garantojnë përfaqësuesve të pakicave barazinë dhe mbrojtjen ligjore të barabartë dhe e ndalon çfarëdo lloj diskriminimi mbi bazën e përkatësisë të pakicës së caktuar. Shtetet obligohen të ndërmarrin masa për përmirësimin e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet qytetarëve pavarësisht përkatësisë fetare, kombëtare, etnike ose gjuhësore, posaçërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe informimit masiv.

Në fushën e edukimit, shtetet nënshkruese duhet të përqipen të sigurojnë kushtet për kultivimin e kulturës, gjuhës dhe fesë së pakicave. Në këtë kuptim, është e domosdoshme ndërmarrja e aktiviteteve për trajnimin e kuadrove të arsimtarëve, zhvillimin e materialeve të mësimdhënies dhe mundësimin e kontakteve dhe shkëmbimin e nxënësve dhe arsimtarëve të komuniteteve të ndryshme. Palët e kontraktuara obligohen të sigurojnë qasje të barabartë në arsim në të gjitha nivelet për përfaqësuesit e pakicave. Pakicat kanë të drejtë të formojnë institucionet e veta arsimore për arsim dhe trajnim. Çdo përfaqësues i pakicave ka të drejtë ta mësojë gjuhën e vet amtare, kurse në zonat e banuara me pakica në numër të madh, në qoftë se për këta ekzistojnë kërkesa të mjaftueshme, duhet të sigurohet, në përputhje me mundësitë e shtetit dhe të sistemit edukativ, mësimi i pakicave në gjuhën amtare apo edukimi i tyre në atë gjuhë.

Karta Rajonale për Gjuhët Evropiane⁴¹

Qëllimi themelor i Kartës është që shtetet nënshkruese t'i pranojnë gjuhët rajonale apo të pakicave si shprehje e pasurisë kulturore, të përmirësojnë studimin dhe kërkimin e gjuhëve

39 Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Këshilli i Evropës, 1950.

40 Konventa kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale, Këshilli i Evropës, Strasburg 1995.

41 Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave, Këshilli i Evropës, Strasburg 1992.



rajonale apo të pakicave në universitete apo institucione të ngjashme. Në këtë mënyrë bëhet kujdesi për identitetin e tyre kulturor si faktor i rëndësishëm i integritetit shoqëror të minoriteteve. Rregulli kundër diskriminimit konsiston në atë që askush nuk duhet të jetë i përjashtuar, kufizuar apo i keqtrajtuar për shkak se përdoron gjuhën e pakicave apo atë rajonale, që do të shkaktonte dekurajimin e dikujt që të përdorë dhe të zhvillojë gjuhën e pakicës të cilës i përket.

Shtetet duhet t'i sigurojnë minoriteteve shkollimin në gjuhët minoritare, kudo që kjo është e mundur, në të gjitha nivelet e edukimit. Kjo përfshinë dhe siguron parakushtet për mësimin/edukimin në gjuhët e pakicave përmes trajnimit të kuadrove arsimuese, si dhe krijimin e kushteve të tjera të domosdoshme për arsimin tërësor dhe funksional në gjuhët e pakicave.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike⁴²

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike përcakton që të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë, pa asnjë lloj diskriminimi, në mbrojtjen e barabartë ligjore. Kjo do të thotë që me ligj duhet të ndalohet çdo diskriminim dhe t'i garantohet të gjithë personave mbrojtja e barabartë dhe efektive kundër çdo lloj diskriminimi, posaçërisht mbi baza racore, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes apo ndonjë statusi tjetër.

Me anë të paktit, ndalohen diskriminimi i përgjithshëm dhe pabarazia përpara ligjit, gjegjësisht përcaktohet norma që asnjë ligj nuk guxon të ketë rregulla diskriminuese pavarësisht nga materia që ai rregullon. Shtetet kanë obligim të mos ia ndërpresin përfaqësuesve të pakicave etnike, fetare apo gjuhësore, kujdesin mbi jetën e tyre kulturore, shprehjen dhe të praktikuarit e fesë që ato kanë apo përdorimin e gjuhës të tyre.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁴³

Qëllimi kryesor i paktit është t'i nxisë shtetet nënshkruese që në mënyrë të vazhdueshme t'i avancojnë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore me qëllim progresin shoqëror të përgjithshëm, parandalimin e konflikteve, varfërisë, shkeljes të të drejtave të njeriut dhe të diskriminimit.

Shtetet nënshkruese janë të obliguara t'ia sigurojnë çdokujt të drejtën në arsim i cili synon zhvillimin e personalitetit, të dinjitetit dhe të fuqizojë respektimin e të drejtave dhe lirive njerëzore. Arsimi, vetvetiu, duhet të jetë i fokusuar në formimin e individit si pjesëmarrës aktiv të jetës shoqërore, të gatshëm t'i kontribuojë mirëkuptimit, zhvillimit të tolerancës dhe miqësisë

42 Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Qytetare dhe Politike, i miratuar me Rezolutën 2200A (XXI) të Kuvendit të Përgjithshëm, me 16 dhjetor të vitit 1966, ndërsa hyri në fuqi me 23 mars të vitit 1976, në pajtim me nenin 49.

43 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i miratuar dhe i hapur për nënshkrim, ratifikim dhe inkuadrim me Rezolutën e Kuvendit të Përgjithshëm 2200A (XXI) me 16 dhjetor të vitit 1966.



ndërmjet njerëzve me origjinë të ndryshme racore, etnike dhe përkatësisë së ndryshme fetare dhe si pasojë, ruajtjen e paqes. Në këtë drejtim, shtetet do të duheshin ta sigurojnë obligueshmërinë dhe disponueshmërinë e arsimit fillor për të gjithë. Arsimi i mesëm gjithashtu, duhet të ishte i disponueshëm për të gjithë dhe të bëhet gradualisht obligator me ndërmarrjen e masave graduale që ai të bëhet pa pagesë. Shtetet duhet të bëjnë gjithçka që edukimi universitar gradualisht të bëhet pa pagesë dhe i disponueshëm për të gjithë në përputhshmëri me aftësitë. Si përfundim, nënshkruesit duhet të punojnë në mënyrë të përkushtuar që ta zgjerojnë rrjetin e shkollave, të zhvillojnë programe të ndryshme të bursave dhe të fuqizojnë në mënyrë të vazhdueshme standardet të stafit të arsimtarëve. Përveç kësaj, duhet të respektohet liria e prindërve që të zgjedhin për fëmijët e tyre edukimin fetar dhe moral i cili i përshtatet më së shumti bindjeve të tyre, në institucionet të përcaktuara nga shteti.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial⁴⁴

Kjo Konventë ka qenë i pari, dhe shumë gjatë i vetmi instrument obligator ndërkombëtar i cili e përkufizoi nocionin e diskriminimit. Konventa shpall çdo doktrinë për superioritet ndërracor si të pabazuar shkencërisht, jo morale dhe dukuri të rrezikshme për shoqërinë e cila duhet të ndalohen me masa aktive, përmes promovimit të tolerancës dhe bashkëjetesës të popujve të ndryshëm të një shteti, por dhe të popujve të ndryshëm në botë.

Obligim i veçantë i shteteve nënshkruese është të ndërmarrin masat në fushën e edukimit dhe arsimit, informimit dhe kulturës që ato të luftojnë kundër paragjykimeve të cilat çojnë tek diskriminimi racor, përmes përmirësimit të mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë ndërmjet popujve, grupeve etnike dhe racore, në frymën e parimeve dhe vlerave të Kombeve të Bashkuara.

Deklarimi për Të Drejtat e Personave që i përkasin pakicave nacionale ose etnike, fetare dhe gjuhësore⁴⁵

Deklarimi është i miratuar me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e përfaqësuesve të pakicave kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore, dhe t'i kontribuojë stabilitetin politik dhe shoqëror të shteteve të nënshkuara.

Obligimi i shtetit është që në territorin e vet ta mbrojë mbijetesën dhe identitetin e pakicave dhe të avancojë kushtet që ai të zhvillohet gjatë gjithë kohës. Në përputhje me këtë Deklarim, individët që i përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore, kanë të drejtë, pa asnjëfarë ndërhyrjeje nga jashtë dhe pa asnjë diskriminim, ta praktikojnë kulturën, fenë

44 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial e miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe inkuadrim me Rezolutën e Kuvendit të Përgjithshëm 2106 A (XX) me 21 dhjetor të vitit 1965, ndërsa hyri në fuqi me 4 janar të vitit 1969, në pajtim me nenin 19.

45 Deklarimi për Të Drejtat e Personave të Cilët i Takojnë Pakicave Nacionale ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore, u miratua dhe u shpallë në Seancën e 47 të Kuvendit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara, me 18 dhjetor të vitit 1992 (rezoluta nr. 47/135).



dhe përdorimin e gjuhës në jetën e tyre private dhe shoqërore. Shteti ka obligim ta sigurojë pjesëmarrjen efektive të pakicave në sferat shoqërore, ekonomike, politike dhe në sferat e tjera të jetës shoqërore, duke përfshirë këtu edhe arsimin. Në fushën e arsimit, shtetet obligohen të ndërmarrin masa nxitëse për marrjen e njohurive nga historia, tradita, gjuha dhe kultura e pakicave të cilat banojnë në rajonin e tyre, si dhe të sigurojnë kushtet për arsimin e pakicave për shoqërinë në të cilën jetojnë dhe për pjesëmarrjen në procesin e marrjes së vendimeve, posaçërisht të atyre vendimeve të cilat i përkasin atyre, si në nivel lokal, ashtu dhe në nivel rajonal. Pakicave duhet t'i sigurohet liria e shprehjes të identitetit të tyre gjersa kjo gjë është në përputhje me ligjin. Kur do që është e mundur, shtetet kanë detyrim t'i mundësojnë pakicave mësimin në gjuhën e tyre dhe në përgjithësi mësimin e gjuhës së pakicave.

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me masat për luftë kundër diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor⁴⁶

Rekomandimi është miratuar me qëllim kundërshtimin e diskriminimit, zhvillimit të përfshirjes sociale të personave me orientim seksual dhe identitet gjinor të ndryshëm. Shtetet që e kanë miratuar duhet të punojnë në largimin e vazhdueshëm të diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si pengesë për realizim e të drejtave dhe lirive njerëzore. Në këtë kuptim, shteti duhet të ndërmarrë masat aktive që t'i sigurojë të drejtën për arsim pa diskriminim mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në mjedis të sigurt, pa dhunë dhe duke eliminuar mënyrat e tjera të veprimit diskriminues. Shtetet duhet të punonin në zhvillimin e tolerancës brenda institucioneve edukative përmes rritjes së mirëkuptimit dhe pranimin të orientimeve seksuale dhe identiteteve gjinore të ndryshme, përmes dhënies së informatave objektive në programet shkollore dhe sigurimit të përkrahjes dhe informimit të të rinjve që ato të jetojnë në përputhshmëri me orientimin e tyre seksual dhe identitetin e tyre gjinor. Në institucionet arsimore duhet të ekzistojnë politikat e paramenduara të barazisë, sigurisë dhe përkrahjes në mbrojtje kundër diskriminimit.

Instrumente të rëndësishëm janë miratuar nga Këshilli i Evropës të cilët mund të jenë të dobishme për zhvillimin e mekanizmave antidiskriminuese në arsim siç janë:

- Direktiva nr. 2000/78/EC me 27 nëntor të vitit 2000, lidhur me kornizën e përgjithshme për të vepruarit e barabartë me qytetarët gjatë punësimit dhe në punë.
- Direktiva nr. 2000/43/ec me 29 qershor të vitit 2000, lidhur me zbatimin e parimeve të të vepruarit e barabartë pavarësisht nga prejardhja raciale dhe etnike.

⁴⁶ Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për masat për luftë kundër diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual ose identitetit gjinor, Këshilli i Evropës, e pranoi Komiteti i Ministrave me 31 mars të vitit 2010 në mbledhjen e 1081 të zëvendës ministrave.

